<p>1.5. Bërja e një ftese për të blerë produktet me një çmim të caktuar pa bërë të ditur ekzistimin e ndonjë baze të arsyeshme, që tregtari mund të ketë për të besuar se ai nuk do të jetë në gjendje që të ofrojë për furnizim ose për të autorizuar një tregtar tjetër për të furnizuar këto produkte ose produkte ekuivalente me atë çmim për atë periudhë dhe në sasi që janë të arsyeshme, duke pasur parasysh produktin, shkallën e reklamimit të produktit dhe çmimin e ofruar, reklamim artificial;</p> <p>1.6. Bërja e ftesës për të blerë produkte me një çmim të caktuar dhe pastaj:</p> <p>1.6.1. Të refuzohet që t'i tregohet konsumatorëve malli i reklamuar, ose;</p> <p>1.6.2. Refuzimi për të marr porosi për atë, apo realizuar dërgesën brenda një kohe të arsyeshme, ose;</p> <p>1.6.3. Demonstrimit të një mostre të dëmtuar, me qëllim të promovimit të një produkti tjetër – ‘karremi dhe produkti’;</p>	<p>complying with the terms of the approval, endorsement or authorisation;</p> <p>1.5 Making an invitation to purchase products at a specified price, without disclosing the existence of any reasonable grounds the trader may have for believing that he/she will not be able to offer for supply or to procure another trader to supply those products or equivalent products at that price for a period that is, and in quantities that are, reasonable having regard to the product, the scale of advertising of the product and the price offered, bait advertising;</p> <p>1.6 Making an invitation to purchase products at a specified price and then:</p> <p>1.6.1 Refusing to show the advertised item to consumers, or;</p> <p>1.6.2 refusing to take orders for it or deliver it within a reasonable time, or;</p> <p>1.6.3 Demonstrating a defective sample of it with the intention of promoting a different product - ‘bait and switch];</p>	<p>tvrdnje bez ispunjavanja uslova za odobrenje, podršku ili ovlašćenje;</p> <p>1.5. Poziv za kupovinu proizvoda sa određenom cenom, bez otkrivanja postojanja bilo kog razumnog osnova, koji trgovac može imati da bi se verovalo da on neće biti u stanju da ga pruži za snabdevanje ili da bi ovlastio drugog trgovca za snabdevanje tim proizvodima ili ekvivalentnih proizvoda tom cenom za taj period i u količinama koje su razumne, imajući u vidu proizvod, nivo reklamiranja proizvoda i ponuđenu cenu, lažno reklamiranje;</p> <p>1.6. Poziv za kupovinu proizvoda po određenoj ceni, i zatim:</p> <p>1.6.1. Odbijanje da se potrošačima pokaže reklamirana roba; ili</p> <p>1.6.2. Odbijanje da se roba naruči za njega, ili da se realizuje narudžbina u razumnom roku; ili</p> <p>1.6.3. Prikazivanje oštećenog uzorka u cilju promocije drugog proizvoda – „mamac i proizvod“;</p>
--	---	---

<p>1.7. Deklarimi i rrejshëm se produkti do të jetë i disponueshëm vetëm për një kohë të kufizuar, ose do të jetë në dispozicion me kushte të veçanta për një kohë të kufizuar, në mënyrë që t'i nxis konsumatorët të marrin vendim të menjëhershëm, duke ua hequr atyre mundësinë ose kohën e mjaftueshme për të bërë një zgjedhje të informuar;</p> <p>1.8. Marrja përsipër për të ofruar shërbime të passhitjes konsumatorëve me të cilët tregtari ka komunikuar para një transaksioni në një gjuhë e cila nuk është gjuhë zyrtare dhe pastaj bërja e shërbimeve të tilla në dispozicion vetëm në një gjuhë tjetër pa i zbuluar këtë qartë konsumatorit para se konsumatori t'i nënshtrohet transaksionit;</p> <p>1.9. Deklarimi apo edhe krijimi i përshtypjes se produkti mund të shitet ligjërisht kur kjo nuk është e mundur;</p> <p>1.10. Paraqitja e të drejtave konsumatorëve të parapara me ligj si tipar dallues i ofertës së tregtarit;</p> <p>1.11. Përdorimi i përmbajtjes editoriale në media për të promovuar një produkt aty ku tregtari ka paguar për promovim pa e bërë këtë të qartë në përmbajtje ose me imazhe apo shprehimisht me zë qartësisht të identifikueshëm nga konsumatori. Sigurimi i</p>	<p>1.7 Falsely stating that a product will only be available for a very limited time, or that it will only be available on particular terms for a very limited time, in order to elicit an immediate decision and deprive consumers of sufficient opportunity or time to make an informed choice;</p> <p>1.8 Undertaking to provide after-sales service to consumers with whom the trader has communicated prior to a transaction in a language which is not an official language and then making such service available only in another language without clearly disclosing this to the consumer before the consumer is committed to the transaction;</p> <p>1.9 Stating or otherwise creating the impression that a product can legally be sold when it cannot;</p> <p>1.10 Presenting rights given to consumers by law as a distinctive feature of the trader's offer;</p> <p>1.11 Using editorial content in the media to promote a product where a trader has paid for the promotion without making that clear in the content or by images or sounds clearly identifiable by the consumer; Providing search results in response to online customer</p>	<p>1.7. Lažna izjava da će proizvod biti na raspolaganju samo na određeno vreme, ili da će biti na raspolaganju sa posebnim uslovima na određeno vreme, kako bi se podstakli potrošači da odmah odluče, ne pružajući im mogućnost ili dovoljno vremena da naprave informisani izbor;</p> <p>1.8. Preuzimanje obaveze da se obezbede usluge nakon prodaje potrošačima sa kojima je trgovac komunicirao pre transakcije na jeziku koji nije službeni jezik, a nakon toga stavljanje takvih usluga na raspolaganje samo na drugom jeziku, bez jasnog otkrivanja toga potrošaču pre nego što potrošač izvrši transakciju;</p> <p>1.9. Izjava ili stvaranje utiska da se proizvod može legalno prodati kada to nije moguće;</p> <p>1.10. Predstavljanje prava potrošača predviđanih zakonom kao prepoznatljiva karakteristika ponude trgovca;</p> <p>1.11. Korišćenje uredničkog sadržaja u medijima za promociju proizvoda tamo gde je trgovac platio za promociju bez jasnog prikazivanja sadržaja ili slikama ili na jasno prepoznatljivom glasu za potrošača. Pružanje rezultata pretrage kao</p>
--	---	--

<p>rezultateve të kërkimit në përgjigje të kërkim-shpjegimeve nga konsumatorët përmes internetit pa shpalosur reklamime apo pagesa posaçërisht për arritjen e një renditjeje më të lartë të produkteve brenda rezultateve të kërkimit;</p> <p>1.12. Bërja e një deklarami materialisht të pasaktë në lidhje me natyrën dhe shkallën e rrezikut të sigurisë personale të konsumatorit dhe familjes së tij, nëse konsumatori nuk e blen produktin;</p> <p>1.13. Promovimi i produktit të ngjashëm me produktin e një prodhuesi specifik, në atë mënyrë që me qëllim të mashtrimit konsumatorin që të besoj se produkti është bërë nga prodhuesi i njëjtë kur kjo nuk është e vërtetë;</p> <p>1.14. Krijimi, operimi ose promovimi i skemave promovuese piramidale aty ku konsumatori merr parasysh mundësinë e pranimit të kompensimit i cili rrjedh kryesisht nga futja e konsumatorëve tjerë në skemë sesa nga shitja ose konsumi i produkteve;</p> <p>1.15. Pretendimi se tregtari është gati t'i jap fund tregtisë ose zhvendos lokalet kur kjo nuk është e vërtetë;</p>	<p>search-explanations without disclosing advertisements or payments specifically to achieve a higher ranking of products within the search results;</p> <p>1.12 Making a materially inaccurate claim concerning the nature and extent of the risk to the personal security of the consumer or their family if the consumer does not purchase the product;</p> <p>1.13 Promoting a product similar to a product made by a particular producer in such a manner as deliberately to mislead the consumer into believing that the product is made by that same producer when it is not;</p> <p>1.14 Establishing, operating or promoting a pyramid promotional scheme where a consumer gives consideration for the opportunity to receive compensation that is derived primarily from the introduction of other consumers into the scheme rather than from the sale or consumption of products;</p> <p>1.15 Claiming that the trader is about to cease trading or move premises when he/she is not;</p>	<p>odgovor na upite potrošača preko interneta bez otkrivanja reklama ili plaćanja posebno za postizanje višeg ranga proizvoda u rezultatima pretrage;</p> <p>1.12. Materijalno netačna izjava vezano za prirodu i nivo rizika lične bezbednosti potrošača i njegove porodice, ako potrošač ne kupi proizvod;</p> <p>1.13. Promovisanje proizvoda sličnog proizvodu specifičnog proizvođača, tako da namerno obmanjuje potrošača da bi verovao da je proizvod napravljen od istog proizvođača, kada to nije istina;</p> <p>1.14. Kreiranje, manipulisanje ili promovisanje promotivnih piramidalnih šema, tamo gde potrošač uzima u obzir dobijanja naknade koja prvenstveno proizilazi iz uvođenja drugih potrošača u šemu, a ne od prodaje ili potrošnje proizvoda;</p> <p>1.15. Tvrdnja da je trgovac spreman da prekine trgovinu ili da premešta poslovne prostorije kada to nije istina;</p>
--	--	--

<p>1.16. Pretendimi se produktet mund të lehtësojnë fitimin në lojërat e fatit;</p> <p>1.17. Pretendimi mashtrues se produkti mund të kuroj sëmundje, mosfunksionim ose deformim;</p> <p>1.18. Dhënia e informatave materialisht të pasakta mbi kushtet e tregut ose mbi disponueshmërinë e produktit me qëllim të nxitjes së konsumatorit që të marr produktin me kushte më pak të favorshme se sa kushtet normale të tregut;</p> <p>1.19. Pretendimi në praktikë tregtare se ofrohet çmim konkurrent apo promovues pa e dhënë në të vërtet këtë çmim apo diçka të barasvlershme;</p> <p>1.20. Përshkrimi i një produkti si ‘gratis’, ‘falas’, ‘pa pagesë’ ose ngjashëm nëse konsumatori duhet të paguaj diçka tjetër përveç çmimit të pashmangshëm që rrjedh nga përgjigjja në këtë praktikë tregtare dhe vjeljes apo pagesave për dorëzimin e artikullit;</p> <p>1.21. Përfshirja në materialin promovues e një fature ose dokumenti të ngjashëm duke kërkuar pagesën e cila i jep përshtypjen konsumatorit se tashmë e ka porositur produktin, kur ai nuk e ka bërë këtë;</p>	<p>1.16 Claiming that certain products are able to facilitate winning in games of chance.</p> <p>1.17 Falsely claiming that a product is able to cure illnesses, dysfunction or malformations;</p> <p>1.18 Passing on materially inaccurate information on market conditions or on the possibility of finding the product with the intention of inducing the consumer to acquire the product at conditions less favourable than normal market conditions;</p> <p>1.19 Claiming in a commercial practice to offer a competition or prize promotion without awarding the prizes described or a reasonable equivalent;</p> <p>1.20 Describing a product as ‘gratis’, ‘free’, ‘without charge’ or similar if the consumer has to pay anything other than the unavoidable cost of responding to the commercial practice and collecting or paying for delivery of the item;</p> <p>1.21 Including in marketing material an invoice or similar document seeking payment which gives the consumer the impression that he/she has already ordered the marketed product when he/she has not;</p>	<p>1.16. Tvrđnja da proizvodi mogu olakšati dobit u igrama na sreću;</p> <p>1.17. Obmanjujuća tvrđnja da proizvod može izlečiti bolest, nefunkcionisanje ili deformaciju;</p> <p>1.18. Davanje materijalno netačnih informacija o tržišnim uslovima ili o dostupnosti proizvoda u cilju podsticanja potrošača da uzme proizvod u manje povoljnijim uslovima od normalnih tržišnih uslova;</p> <p>1.19. Tvrđnja u poslovnoj praksi da se pruža konkurentna ili promotivna cena bez davanja takve cene u stvarnosti ili nešto ekvivalentno;</p> <p>1.20. Opis proizvoda kao „gratis“, „besplatno“, „bez naplate“ ili slično, ako potrošač treba da plati nešto drugo osim neizbežne cene koja proizilazi iz odgovora na ovu poslovnu praksu i naplate ili plaćanja za dostavu artikla.</p> <p>1.21. Uključivanje promotivnog materijala u fakturu ili sličnom dokumentu, tražeći isplatu koja potrošaču daje utisak da je već naručio proizvod, kada on to nije učinio.</p>
---	--	---

<p>1.22. Pretendimi i rrejshëm ose krijimi i përshtypjes se tregtari nuk është duke vepruar për qëllimet e lidhura me tregtinë, biznesin, zejen ose profesionin e tij, ose përfaqësimi i rrejshëm i vetës si konsumator;</p> <p>1.23. Krijimi i rrejshëm i përshtypjes se shërbimi pas shitjes në lidhje me një produkt është i disponueshëm në një shtet tjetër, nga ai ku produkti është shitur;</p> <p>1.24. Rishitja e biletave të ngjarjeve konsumatorëve nëse tregtari i ka blerë ato duke përdorur mjete të automatizuara për të anashkaluar çdo kufi të vendosur në numrin e biletave që një person mund të blejë ose ndonjë rregull tjetër që zbatohet për blerjen e biletave;</p> <p>1.25. Përmes deklaramentit që rishikimi i një produkti është ofruar nga konsumatorët që kanë përdorur ose blerë në të vërtetë produktin pa marrë hapa të arsyeshëm dhe proporcional për të verifikuar nëse ato vijnë nga konsumatorë të tillë;</p> <p>1.26. Angazhimi ose porositja e një personi tjetër juridik ose fizik për të dhënë vlerësime ose paraqitje të rreme ndaj konsumatorëve ose vërtetime sociale, me qëllim të promovimit të produkteve.</p>	<p>1.22 Falsely claiming or creating the impression that the trader is not acting for purposes relating to his trade, business, craft or profession, or falsely representing oneself as a consumer;</p> <p>1.23 Creating the false impression that after-sales service in relation to a product is available in another country, from where the product is sold.</p> <p>1.24 Resale of consumer event tickets if the trader has purchased them using automated devices to circumvent any limit set on the number of tickets a person can purchase or any other rules that apply to tickets;</p> <p>1.25 By stating that a review of a product has been provided by consumers who have actually used or purchased the product without taking reasonable and proportionate steps to verify whether they come from such consumers;</p> <p>1.26 Engaging or ordering another legal or natural person to give false customer evaluations or appearances or social certifications in order to promote products.</p>	<p>1.22. Lažna tvrdnja ili stvaranje utiska da trgovac ne postupa u cilju koji se odnosi na trgovinu, poslovanje, zanat ili njegovu profesiju ili lažno predstavljanje samog sebe kao potrošača;</p> <p>1.23. Stvaranje lažnog utiska da je usluga nakon prodaje u vezi sa proizvodom dostupna u drugoj zemlji, odakle se taj proizvod prodao.</p> <p>1.24. Preprodaja karata za događaje potrošačima ako ih je trgovac kupio koristeći automatizovana sredstva da zaobiđe bilo koje ograničenje postavljeno na broj karata koje jedna osoba može da kupi ili bilo koje drugo pravilo koje se primenjuje na kupovinu karata;</p> <p>1.25. Izjavom da su proizvod testirali potrošači koji su zaista koristili ili kupili proizvod bez preduzimanja razumnih i srazmernih koraka kako bi proverili da dolaze od takvih potrošača;</p> <p>1.26. Angažovanje ili naručivanje drugog pravnog ili fizičkog lica da potrošačima pruža lažne ocene ili predstavljanja ili društvene dokaze u cilju promovisanja proizvoda.</p>
--	---	---

<p>2. Praktikrat tregtare agresive:</p> <p>2.1. Krijimi i përshtypjes se konsumatori nuk mund të lëshoj lokalet derisa kontrata nuk lidhet;</p> <p>2.2. Zhvillimi i vizitës personale tek shtëpia e konsumatorit duke shpërfillur kërkesën e konsumatorit për tu larguar ose për të mos u kthyer, përveç në rrethanat dhe masën e justifikuar për të zbatuar një detyrim kontraktual;</p> <p>2.3. Bërja e kërkesave të vazhdueshme me telefon, faks, e-mail ose medime tjera nga larg, përveç në rrethanat dhe masës së justifikueshme për zbatimin e një detyrimi kontraktual;</p> <p>2.4. Të kërkoj nga konsumatori i cili dëshiron të marr një policë sigurimi, të siguroj/ofroj dokumente të cilat nuk janë të rëndësishme sa i përket vlefshmërisë së kërkesës, apo mos përgjigja sistematike në një korrespondencë të vazhdueshme në mënyrë që një konsumator të dekurajohet dhe të mos i ushtroj të drejtat e tij kontraktuale;</p> <p>2.5. Përfshirja brenda reklamës nxitëse të drejtpërdrejtë drejtuar fëmijëve për të blerë produktet e reklamuar ose për t'i bindur</p>	<p>2. Aggressive commercial practices:</p> <p>2.1. Creating the impression that the consumer cannot leave the premises until the contract is formed;</p> <p>2.2. Conducting a visit at the consumer's home, ignoring the consumer request to leave his home or not to return except in circumstances and to the extent justified under national law to enforce a contractual obligation;</p> <p>2.3. Making persistent and unwanted solicitations by telephone, fax, e-mail or other remote media except in circumstances and to the extent justified to enforce a contractual obligation;</p> <p>2.4. Requiring a consumer who wishes to claim on an insurance policy to produce/provide documents which could not reasonably be considered relevant as to whether the claim was valid, or failing systematically to respond to pertinent correspondence, in order to dissuade a consumer from exercising his contractual rights;</p> <p>2.5. Including in an advertisement a direct exhortation to children to buy advertised</p>	<p>2. Agresivna poslovna praksa:</p> <p>2.1. Stvaranje utiska da potrošač ne može da napušta poslovne prostorije dok ugovor ne bude sklopljen;</p> <p>2.2. Realizacija lične posete kod kuće potrošača, ignorirajući zahtev potrošača za odlazak ili da se ne vrati, osim u slučajevima i u opravdanoj meri za izvršavanje ugovorne obaveze;</p> <p>2.3. Stalni zahtevi putem telefona, faksa, e-maila ili drugih medija iz daljine, osim u slučajevima i u opravdanoj meri za izvršavanje ugovorne obaveze;</p> <p>2.4. Zahtevanje od potrošača koji želi da uzima polisu osiguranja, da obezbedi/pruža dokumente koji nisi značajni što se tiče važenja zahteva, ili sistematsko ne odazivanje u stalnoj prepisci tako da se potrošač obeshrabri i da ne ostvari svoja ugovorna prava;</p> <p>2.5. Uključivanje u okviru podsticajne reklame koja je direktno upućena deci za kupovinu reklamiranih proizvoda ili da</p>
---	---	--

<p>prindërit e tyre ose të rriturit e tjerë për t'ua blerë produktet atyre;</p> <p>2.6. Kërkesa e pagesës së menjëhershme ose të shtyrë nga tregtari për produkte, në lidhje me furnizimin apo kthimin ose ruajtjen e këtyre produkteve të pakërkua nga konsumatori. Informimi eksplícit i konsumatorit se nëse ai nuk e blen produktin ose shërbimin, veprimtaria ose jetesa e tregtarit do të jetë në rrezik;</p> <p>2.7. Krijimi i rrejshëm i përshtypjes se konsumatori tanimë veç ka fituar, do të fitoj, ose do të fitoj pas kryerjes së ndonjë veprimi të veçantë ndonjë çmim ose përfitim ekuivalent, kur në fakt as:</p> <p>2.7.1. Nuk ka çmim ose përfitim ekuivalent, apo;</p> <p>2.7.2. Çdo veprim në lidhje me pretendimin në çmim ose përfitimin ekuivalent i nënshtrohet pagesës me para nga konsumatori ose shkakton kosto.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Veprimet mashtruese</p> <p>1. Praktikant tregtare konsiderohet si mashtruese nëse përmbajnë informata jo të sakta dhe si të tilla</p>	<p>products or persuade their parents or other adults to buy advertised products for them;</p> <p>2.6. Demanding immediate or deferred payment for or the return or safe-keeping of products supplied by the trader, but not solicited by the consumer; Informing the consumer explicitly that if he does not buy the product or service, the trader's activity or life will be in jeopardy;</p> <p>2.7. Creating the false impression that the consumer has already won, will win, or will on doing a particular act win, a prize or other equivalent benefit, when in fact either:</p> <p>2.7.1. There is no prize or other equivalent benefit, or</p> <p>2.7.2. Taking any action in relation to claiming the prize or other equivalent benefit is subject to the consumer paying money or incurring a cost.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Misleading actions</p> <p>1. A commercial practice shall be regarded as misleading if it contains false information and is</p>	<p>ubede njihove roditelje ili druge odrasle da im kupuju te proizvode;</p> <p>2.6. Zahtev za trenutno ili odloženo plaćanje od strane trgovca za proizvode, u vezi sa snabdevanjem ili vraćanjem ili čuvanjem ovih proizvoda koje potrošač nije tražio. Eksplicitno informisanje potrošača da ako ne kupi proizvod ili uslugu, delatnost ili život trgovca će biti u opasnosti;</p> <p>2.7. Lažno stvaranje utiska da je potrošač već osvojio, da će osvojiti, ili da će osvojiti nakon izvršavanja neke posebne radnje neku nagradu ili ekvivalentnu dobit, kada u stvari:</p> <p>2.7.1. Ne postoji nagrada ili ekvivalentna dobit; ili</p> <p>2.7.2. Svaka radnja u vezi sa tvrdnjom o nagradi ili ekvivalentnoj dobiti, podleže plaćanju novca od strane potrošača ili prouzrokuje troškove.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Obmanjujuće radnje</p> <p>1. Poslovna praksa se smatra obmanjujućom ako sadrži netačne informacije i kao takve su</p>
---	---	--

<p>janë të pabesueshme apo në çfarëdo mënyre, përfshirë prezantimin e përgjithshëm, mashtrojnë konsumatorin e zakonshëm edhe nëse informacioni faktik është i saktë në relacion me një apo me më shumë elemente sikurse në vijim, dhe se shkakton apo mund të shkaktoj një vendimmarrje transaksioni të cilën konsumatori përndryshe nuk do ta kishte marrë:</p> <p>1.1. Ekzistenca apo natyra e produktit;</p> <p>1.2. Karakteristikat kryesore të produktit siç janë disponueshmëria e tij, përfitimet, rreziqet, ekzekutimi, përbërja, aksesoret, asistenca ndaj klientit pas shitjes, trajtimi i ankesave, metoda dhe data e prodhimit apo ofrimit, dërgesa, përdorimi, sasia, specifikimi, origjina gjeografike apo tregtare apo rezultati i cili pritet nga përdorimi i tij, apo rezultati dhe karakteristikat materiale të testeve apo kontroleve të kryera mbi produktin.</p> <p>2. Nivelin e angazhimeve të tregtarit, motivet për praktikën tregtare dhe natyrën e procesit të shitjes, çdo deklaratë apo simbol në lidhje me sponsorimin direkt apo indirekt apo aprovimin e tregtarit apo të produktit:</p> <p>2.1. Çmimi dhe mënyra në të cilën është llogaritur çmimi, apo ekzistenca e përfitimeve specifike nga çmimi;</p>	<p>therefore untruthful or in any way, including overall presentation, deceives or is likely to deceive the average consumer, even if the information is factually correct, in relation to one or more of the following elements, and in either case causes or is likely to cause him to take a transactional decision that he would not have taken otherwise:</p> <p>1.1. The existence or nature of the product:</p> <p>1.2. The main characteristics of the product, such as its availability, benefits, risks, execution, composition, accessories, after-sale consumer assistance and complaint handling, method and date of manufacture or provision, delivery, fitness for purpose, usage, quantity, specification, geographical or commercial origin or the results to be expected from its use, or the results and material features of tests or checks carried out on the product;</p> <p>2. The extent of the trader's commitments, the motives for the commercial practice and the nature of the sales process, any statement or symbol in relation to direct or indirect sponsorship or approval of the trader or the product:</p> <p>2.1. The price or the manner in which the price is calculated, or the existence of a specific price advantage;</p>	<p>nepouzdana ili na bilo koji način, uključujući celokupnu prezentaciju, obmanjuju običnog potrošača, iako je činjenična informacija tačna u odnosu na jedan ili više sledećih elemenata i da prouzrokuje ili može prouzrokovati odluku o transakciji koju potrošač inače ne bi doneo:</p> <p>1.1. Postojanje ili priroda proizvoda;</p> <p>1.2. Glavne karakteristike proizvoda, kao što je njegova dostupnost, koristi, rizici, izvršenje, sastav, dodatna sredstva, pomoć potrošaču nakon prodaje, razmatranje žalbi, metoda i datum proizvodnje ili pružanja, isporuka, upotreba, količina, specifikacija, geografsko ili trgovačko poreklo ili rezultat koji se očekuje od upotrebe proizvoda, ili rezultat i materijalne karakteristike testova i kontrola izvršenih na proizvodu;</p> <p>2. Nivo angažovanja trgovca, motivi za poslovnu praksu i priroda procesa prodaje, svaka izjava ili simbol u vezi sa posrednim ili neposrednim sponzorstvom ili odobravanjem trgovca ili proizvoda:</p> <p>2.1. Cena i način na koji je cena obračunata ili postojanje specifičnih koristi od cene;</p>
--	---	---

<p>2.2. Nevoja për një shërbim, pjesë, zëvendësim apo riparim;</p> <p>2.3. Natyra, atributet dhe të drejtat e tregtarit ose të agjentit të tij, siç janë identiteti dhe pronësitë e tregtarit, kualifikimi, çmimet e fituara, statusi, miratimi, anëtarësimi ose lidhja dhe zotërimi nga ana e tij i të drejtave mbi pronësinë industriale, tregtare apo intelektuale;</p> <p>2.4. Të drejtat e konsumatorit, duke përfshirë të drejtën për zëvendësim apo rimbursim sipas këtij ligji, kur kemi të bëjmë me aspekte të shitjes së mallrave konsumatorëve dhe garancitë e lidhura dhe/apo rreziqet me të cilat ai mund të përballet.</p> <p>3. Një praktikë tregtare është mashtruese nëse në kontekstin faktik, duke marrë parasysh të gjitha karakteristikat dhe rrethanat, shkakton apo mund të shkaktoj që konsumatori i zakonshëm të marrë një vendim transaksioni të cilin përndryshe nuk do ta kishte marrë, dhe kjo përfshin:</p> <p>3.1. Çdo reklamim i produktit, përfshirë reklamimin krahasues, i cili krijon konfuzion me çdo produkt, markë tregtare, emër tregtar apo ndonjë shenjë tjetër dalluese të konkurruesit;</p>	<p>2.2. The need for a service, part, replacement or repair;</p> <p>2.3. The nature, attributes and rights of the trader or his agent, such as his identity and assets, qualifications, prices won, status, approval, affiliation or connection and ownership of industrial, commercial and intellectual property rights;</p> <p>2.4. Consumers' rights, including the right to replacement or reimbursement under this law, when dealing with the aspects of selling the products to consumers and associated guarantees and/or risks that he/she may face;</p> <p>3. A commercial practice shall also be regarded as misleading if, in its factual context, taking account of all its features and circumstances, it causes or is likely to cause the average consumer to take a transactional decision that he would not have taken otherwise, and it involves:</p> <p>3.1. Any marketing of a product, including comparative advertising, which creates confusion with any products, trademarks, trade names or other distinguishing marks of a competitor;</p>	<p>2.2. Potreba za uslugom, delom, zamenom ili popravkom;</p> <p>2.3. Priroda, atributi i prava trgovca ili njegovog agenta, kao što su identitet i vlasništvo trgovca, kvalifikacija, dobijene cene, status, odobrenje, članstvo ili veza i industrijska, trgovačka ili intelektualna svojina prava sa njegove strane;</p> <p>2.4. Prava potrošača, uključujući pravo na zamenu ili nadoknadu u skladu sa ovim zakonom, kada se radi o aspektima prodaje robe potrošačima i povezanim garancijama i/ili rizicima sa kojima se može suočiti.</p> <p>3. Poslovna praksa je obmanjujuća ako u činjeničnom kontekstu, uzimajući u obzir sve karakteristike i okolnosti, prouzrokuje ili može prouzrokovati da običan potrošač donese odluku o transakciji koju inače ne bi doneo, a to uključuje:</p> <p>3.1. Svako reklamiranje proizvoda, uključujući uporedno reklamiranje, koje stvara zbunjenost sa bilo kojim proizvodom, žigom, nazivom proizvoda ili drugom oznakom konkurenta;</p>
---	---	--

<p>3.2. Mos pajtueshmëria e tregtarit me angazhimet që përmbajnë kodet e sjelljes për të cilat ai ka lidhur marrëveshje, me ç'rast:</p> <p>3.2.1. Angazhimi nuk është aspirues por i qëndrueshëm dhe verifikueshëm;</p> <p>3.2.2. Tregtari tregon në praktikën tregtare se ai i përmbahet kodit;</p> <p>3.3. Çdo tregtim i mallit si identik me një mall të tregtuar në një vend tjetër, përderisa ai mall ka përbërje ose karakteristika dukshëm të ndryshme, përveç nëse arsyetohet nga faktorë legjitim dhe objektiv.</p>	<p>3.2. Non-compliance by the trader with commitments contained in codes of conduct by which the trader has undertaken to be bound, where:</p> <p>3.2.1. The commitment is not aspirational but is firm and is capable of being verified;</p> <p>3.2.2. The trader indicates in a commercial practice that he/she is bound by the code;</p> <p>3.3. Any trade in a commodity as identical to a commodity traded in another country, as long as such a commodity has significantly different composition or characteristics unless justified by legitimate and objective factors.</p>	<p>3.2. Neusklađenost trgovca sa angažovanjima koje sadrže kodekse ponašanja, a za koje je on sklopio ugovor, i u tom slučaju:</p> <p>3.2.1. Angažovanje nije sa aspiracijom, ali je održivo i proverljivo;</p> <p>3.2.2. Trgovac pokazuje poslovnom praksom da se pridržava kodeksu;</p> <p>3.3. Svako trgovanje robom kao identične robi kojom se trguje u drugoj zemlji, dok ta roba ima značajno drugačiji sastav ili karakteristike, osim ako je to opravdano legitimnim i objektivnim faktorima.</p>
<p>Neni 10 Lëshimet mashtruese</p>	<p>Article 10 Misleading omissions</p>	<p>Član 10 Obmanjujući propusti</p>
<p>1. Praktika tregtare është mashtruese, nëse në kontekstin faktik, duke marrë parasysh të gjitha karakteristikat dhe rrethanat si dhe kufizimet e mjeteve të komunikimit, nuk përfshinë informatat materiale të cilat i nevojiten konsumatorit të zakonshëm, në kontekst të marrjes së një vendimi për transaksion në bazë të informatave, me ç'rast shkakton apo mund të shkaktoj që konsumatori i</p>	<p>1. A commercial practice shall be regarded as misleading if, in its factual context, taking account of all its features and circumstances and the limitations of the communication medium, it omits material information that the average consumer needs, according to the context, to take an informed transactional decision and thereby causes or is likely to cause the average consumer</p>	<p>1. Poslovna praksa je obmanjujuća, ako u činjeničnom kontekstu, uzimajući u obzir sve karakteristike i okolnosti kao i ograničenja sadržaja komunikacije, ne uključuje materijalne informacije koje su potrebne običnom potrošaču, u kontekstu donošenja odluke o transakciji na osnovu informacija, čime prouzrokuje ili može prouzrokovati da</p>

<p>zakonshëm të merr vendim për transaksion të cilin përndryshe nuk do ta kishte marr.</p> <p>2. Lëshim mashtrues do të konsiderohet kur një tregtar, marrë parasysh çështjet e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, fsheh ose ofron informata materiale të paqarta, të pakuptueshme, jo në kohë të duhur siç janë referuar në atë paragraf, apo dështon që të identifikoj qëllimin e praktikës tregtare nëse ajo tashmë nuk është e qartë nga konteksti, dhe kur në secilin rast kjo shkakton ose mund të shkaktoj që konsumatori i zakonshëm të marrë një vendim të cilin përndryshe nuk do ta kishte marr.</p> <p>3. Kur mjete i përdorur për komunikimin e praktikave tregtare imponon kufizimet në kohë dhe hapësirë, këto kufizime dhe çdo masë tjetër e ndërmarr nga tregtari për të vënë në dispozicion konsumatorit informatat përmes mjeteve të tjera, duhet marr parasysh për të vërtetuar nëse ndonjë informatë është neglizhuar.</p> <p>4. Në rastin e një ftese për blerje, nëse kjo nuk është e qartë nga vet konteksti, informatat në vijim do të konsiderohen si materiale:</p> <p>4.1. Karakteristikat kryesore të produktit, deri në nivelin e përshtatshëm për mjetin e komunikimit dhe produktin;</p>	<p>to take a transactional decision that he would not have taken otherwise.</p> <p>2. It shall also be regarded as a misleading omission when taking account of the matters described in paragraph 1. of this Article, a trader hides or provides in an unclear, unintelligible, ambiguous or untimely manner such material information as referred to in that paragraph or fails to identify the commercial intent of the commercial practice if not already apparent from the context, and where, in either case, this causes or is likely to cause the average consumer to take a transactional decision that he would not have taken otherwise.</p> <p>3. Where the medium used to communicate the commercial practice imposes limitations of space or time, these limitations and any measures taken by the trader to make the information available to consumers by other means shall be taken into account in deciding whether information has been omitted.</p> <p>4. In the case of an invitation to purchase, the following information shall be regarded as material, if not already apparent from the context:</p> <p>4.1. The main characteristics of the product, to an extent appropriate to the medium and the product;</p>	<p>običan potrošač donese odluku o transakciji koju inače ne bi doneo.</p> <p>2. Obmanjujući propust će se smatrati kada trgovac, uzimajući u obzir pitanja opisana u stavu 1. ovog člana, sakrije ili pruža nejasne materijalne, nerazumljive, neblagovremene informacije kao što je navedeno u tom stavu, ili ne uspeva da identifikuje cilj poslovne prakse ako ona već nije jasna iz konteksta, i kada u svakom slučaju to prouzrokuje ili može prouzrokovati da običan potrošač donese odluku koju inače ne bi doneo.</p> <p>3. Kada sredstvo iskorišćeno za saopštavanje poslovne prakse nameće ograničenja u vremenu i prostoru, ova ograničenja i svaku drugu preduzetu meru od strane trgovca da bi se stavile na raspolaganju potrošača informacije putem drugih sredstava, treba uzeti u obzir kako bi se utvrdilo da bilo koja informacija nije zanemarena</p> <p>4. U slučaju poziva za kupovinu, ako to nije jasno iz samog konteksta, sledeće informacije će se smatrati kao materijalne:</p> <p>4.1. Glavne karakteristike proizvoda, do odgovarajućeg nivoa za sredstvo komunikacije i proizvod;</p>
--	---	---

<p>4.2. Adresa gjeografike dhe identiteti i tregtarit, siç janë: emri i tregtarit dhe, aty ku është e zbatueshme, adresa gjeografike dhe identiteti i tregtarit në emër të-të cilit vepron;</p> <p>4.3. Çmimi duke përfshirë taksat, apo kur natyra e produktit shpjegon se çmimi nuk mund të llogaritet në mënyre të arsyeshme paraprakisht, mënyra se si është llogaritur, si dhe kur është e përshtatshme, të gjitha ngarkesat shtesë, tarifatat postare apo të dërgesave, ose kur këto tarifa nuk mund të llogariten paraprakisht, faktin se këto tarifa shtesë mund të jenë të pagueshme;</p> <p>4.4. Marrëveshjet për pagesa, dorëzim dhe performancë, nëse ato largohen nga kërkesat e kujdesit profesional;</p> <p>4.5. Ekzistenca e së drejtës për heqje dore ose anulim për mallrat dhe transaksionet, që e përfshijnë një të drejtë të tillë;</p> <p>4.6. Për produktet e ofruara në tregjet elektronike, pavarësisht nëse pala e tretë që ofron produktet është një tregtar apo jo, në bazë të deklaratës së asaj pale të tretë për ofruesin e tregut në internet.</p>	<p>4.2. The geographical address and the identity of the trader, such as his trading name and, where applicable, the geographical address and the identity of the trader on whose behalf he is acting;</p> <p>4.3. The price inclusive of taxes, or where the nature of the product means that the price cannot reasonably be calculated in advance, the manner in which the price is calculated, as well as, where appropriate, all additional freight, delivery or postal charges or, where these charges cannot reasonably be calculated in advance, the fact that such additional charges may be payable;</p> <p>4.4. The arrangements for payment, delivery and performance, if they avert from the requirements of professional diligence;</p> <p>4.5. The existence of a right of renunciation or cancellation for goods and transactions, including such a right thereof;</p> <p>4.6. For the products offered in the electronic markets, regardless of whether the third party offering the products is a trader or not, based on that third party's statement to the online market provider.</p>	<p>4.2. Geografska adresa i identiteti i tregtarit, kao što su: naziv trgovca, tamo gde je primenjivo, geografska adresa i identiteti trgovca u čije ime se deluje;</p> <p>4.3. Cena, uključujući takse ili kada priroda proizvoda objašnjava da se cena ne može izračunati unapred na razuman način, način na koji je izračunata, kako i gde je prikladno, sve dodatne odgovornosti, naknade za poštarinu ili isporuku, ili kada se ove naknade ne mogu unapred izračunati, činjenica da ove naknade mogu biti isplative;</p> <p>4.4. Sporazumi o plaćanju, isporuci i performanse, ako oni odstupaju od zahteva profesionalne pažnje;</p> <p>4.5. Postojanje prava na odricanje ili poništavanje za robe i transakcije, koje uključuju takvo pravo.</p> <p>4.6. Za proizvode koji se nude na elektronskim tržištima, bez obzira da li je treće lice koje nudi proizvode trgovac ili ne, na osnovu izjave te trećeg lica datoj dobavljaču internet tržišta.</p>
--	--	--

<p>5. Kërkesat e përcaktuara në relacion me komunikimin tregtar përfshi reklamimin apo marketingun, ku një listë jo e plotë do të rregullohet me akt nënligjor.</p> <p>6. Kur konsumatorëve u ofrohet mundësia për të kërkuar për produktet e ofruara nga tregtarë të ndryshëm ose nga konsumatorët në bazë të një pyetjeje në formën e një fjale kyçe, fraze ose informacion tjetër, pavarësisht se ku apo kur arrihen përfundimisht transaksionet, informacioni i përgjithshëm, i disponueshëm në një seksion specifik në faqe në internet që është drejtpërdrejt dhe lehtësisht i arritshëm nga faqja ku paraqiten rezultatet e hulumtimit, mbi parametrat kryesorë që përcaktojnë renditjen e produkteve të paraqitura tek konsumatori si rezultat i pyetjes së kërkimit dhe rëndësisë relative të këtyre parametrave, në krahasim me parametrat e tjerë, do të konsiderohen si materiale. Ky paragraf nuk zbatohet për ofruesit e shërbimeve të kërkimit në internet.</p> <p>7. Kur një tregtar ofron qasje në rishikimet e produkteve të konsumatorëve, informacioni nëse dhe si tregtari siguron që komentet e publikuara vijnë nga konsumatorët që e kanë përdorur ose blerë produktin në të vërtetë, do të konsiderohet si materiale.</p>	<p>5. Requirements set out in relation to commercial communication including advertising or marketing, where an incomplete list shall be regulated by a bylaw.</p> <p>6. When consumers are given the opportunity to search for products offered by different traders or consumers based on a query in the form of a keyword, phrase or other information, regardless of where or when the transactions are finally reached, the general information available in a specific section of the website that is directly and easily accessible from the website where the research results are presented, on the key parameters that determine the ranking of products presented to the consumer as a result of the search query and the relative importance of these parameters compared to other parameters, shall be considered as materials. This paragraph shall not apply to online search service providers.</p> <p>7. When a trader provides access to customer product reviews, information on whether and how a trader ensures that published comments come from consumers who have actually used or purchased the product shall be considered material.</p>	<p>5. Zahtevi propisani u odnosu na poslovnu komunikaciju, uključujući reklamiranje ili marketing, gde će se nepotpuni spisak uređivati podzakonskim aktom.</p> <p>6. Kada se potrošačima pruža mogućnost da traže proizvode koje nude različiti trgovci ili potrošači na osnovu upita u obliku ključne reči, fraze ili drugih informacija, bez obzira na to gde i kada se transakcije na kraju ostvare, opšte informacije, dostupne u određenom odeljku na internet stranici koja je direktno i lako dostupna sa stranice na kojoj su prezentovani rezultati istraživanja, o glavnim parametrima koji određuju rangiranje proizvoda predstavljenih potrošaču kao rezultat upita za pretragu i relativnog značaja ovih parametara, u odnosu na druge parametre, smatraće se materijalnim. Ovaj stav se ne odnosi na pružaoce usluga pretraživanja na internetu.</p> <p>7. Kada trgovac omogući pristup recenzijama potrošačkih proizvoda, informacije o tome da li i kako trgovac obezbeđuje da objavljeni komentari dolaze od potrošača koji su zaista koristili ili kupili proizvod smatraće se materijalnim.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 11 Praktikat agresive tregtare</p> <p>Një praktikë tregtare është agresive kur, nëse duke konsideruar të gjitha tiparet dhe rrethanat e saj, dobëson apo ka mundësi të dobësoj ndjeshëm lirinë e zgjedhjes ose sjelljen e konsumatorit për mallin apo shërbimin, nëpërmjet ushtrimit të dhunës psikike dhe/ose fizike, ose insistimit të tepruar dhe në këtë mënyrë, e shtyn konsumatorin të marre një vendim, të cilin, në të kundërtën, nuk do ta kishte marr.</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Aggressive commercial practices</p> <p>A commercial practice shall be regarded as aggressive if, taking account of all the features and circumstances, significantly impairs or is likely to impair the freedom of choice or consumer's behaviour with regard to commodity or service by exercising psychological and/or physical violence, or excessive influence and thus causing the consumer to take a decision he would not have taken otherwise.</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Agresivna poslovna praksa</p> <p>Poslovna praksa je agresivna kada, uzimajući u obzir sve karakteristike i njene okolnosti, oslabljuje ili ima mogućnost da znatno oslabljuje slobodu izbora ili ponašanje potrošača za robu ili uslugu, putem upotrebe psihičkog i/ili fizičkog nasilja ili preteranog insistiranja i na taj način nameće potrošaču da donese odluku koju, u suprotnom, ne bi doneo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Ngacmimi, presioni apo ndikimi i padrejtë</p> <p>1. Për të përcaktuar nëse një praktikë tregtare përdor dhunën psikike dhe/ose fizike, ose ndikimin e tepruar, merren parasysh:</p> <p>1.1. Kohëzgjatja, vendndodhja, natyra apo insistimi;</p> <p>1.2. Përdorimi i gjuhës apo sjelljes kërcënuese dhe fyese;</p> <p>1.3. Shfrytëzimi nga ana e tregtarit të ndonjë fatkeqësie apo rrethane të përmasave të ngjashme që dëmton gjykimin e konsumatorit për të cilin tregtari është i informuar, për të</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Use of harassment, coercion or undue influence</p> <p>1. In determining whether a commercial practice uses psychic/physical force or undue influence, account shall be taken of:</p> <p>1.1. Its timing, location, nature or persistence;</p> <p>1.2. The use of threatening or abusive words or behaviours;</p> <p>1.3. The exploitation by the trader of any specific misfortune or circumstance of such gravity as to impair the consumer's judgment, of which the trader is aware, to influence the</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Uznemiravanje, pritisak ili nedozvoljeni uticaj</p> <p>1. Da bi se utvrdilo dali poslovna praksa koristi psihološko ii/li fizičko nasilje, ili preterani uticaj, uzimaju se u obzir:</p> <p>1.1. Trajanje, lokacija, priroda ili insistiranje;</p> <p>1.2. Upotreba pretećeg i uvredljivog jezika ili ponašanja;</p> <p>1.3. Korišćenje od strane trgovca bilo koje nesreće ili okolnosti slične razmere koja narušava prosuđivanje potrošača o kojoj je trgovac informisan, radi uticanja na odluku potrošača vezano za proizvod;</p>

<p>ndikuar në vendimin e konsumatorit në lidhje me produktin;</p> <p>1.4. Çfarëdo pengese e madhe ose jo proporcionalë jo kontraktuale e vendosur nga tregtari kur konsumatori dëshiron që të ushtrojë të drejtën sipas kontratës, përfshirë të drejtën për ndërprerje të kontratës, ndërrimin e produktit apo tregtarit;</p> <p>1.5. Çdo kërcenim për të ndërmarr një veprim që ligjërisht nuk mund të merret.</p>	<p>consumer's decision with regard to the product;</p> <p>1.4. Any onerous or disproportionate non-contractual barriers imposed by the trader where a consumer wishes to exercise rights under the contract, including rights to terminate a contract or to switch to another product or another trader;</p> <p>1.5. Any threat to take any action that cannot legally be taken.</p>	<p>1.4. Bilo koja velika ili nesrazmerna neugovorna prepreka nametnuta od strane trgovca kada potrošač želi da ostvari pravo iz ugovora, uključujući pravo na raskid ugovora, zamenu proizvoda ili trgovca;</p> <p>1.5. Svaka pretnja za preduzimanje radnje koja se zakonski ne može preduzeti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Mesazhet përmes materialeve reklamuese</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Messages through advertising materials</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Poruke preko reklamnog materijala</p>
<p>1. Shpërndarja e mesazheve dhe materialeve tjera reklamuese është përgjegjësi e tregtarit lidhur me cilësinë e mallrave dhe shërbimeve të cilat i reklamon përmes këtyre mesazheve.</p> <p>2. Përcjellja e mesazheve publike reklamuese nga telefonia mobile dhe posta elektronike, duhet të këtë lidhëzën e mesazhit për mundësinë e anulimit të abonimit.</p>	<p>1. Distribution of advertising messages and other materials shall be the responsibility of the trader regarding the quality of commodities and services which he advertises through these messages.</p> <p>2. Sending public advertising messages from cellular telephones and electronic mail should have the message body to be able to annul the subscription.</p>	<p>1. Distribucija poruka i drugog reklamnog materijala je odgovornost trgovca u vezi sa kvalitetom robe i usluga koje reklamira putem ovih poruka.</p> <p>2. Prosleđivanje javnih reklamnih poruka sa mobilnih telefona i elektronske pošte treba da sadrži link u poruci za mogućnost otkazivanja pretplate.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Ndalimi i shpërndarjes së materialeve reklamuese</p> <p>1. Është e ndaluar vendosja e mesazheve apo materiale reklamuese në kutitë postare dhe në derë,</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Prohibition of distribution of promotional materials</p> <p>1. It shall be forbidden to leave messages or advertising materials in mailboxes and at the door</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Zabrana distribucije reklamnog materijala</p> <p>1. Zabranjeno je postavljanje poruka ili reklamnih materijala u poštanskim</p>

<p>në qoftë se konsumatori e ka vendosur ndalesën e shkruar qartë për të mos i vendosur ato.</p> <p>2. Ndalohet shpërndarja e materialeve në shtëpi ku nuk ka ndonjë vend adekuat për to.</p> <p>3. Ndalohet shpërndarja e fletëpalosjeve mbi vetura.</p>	<p>if the consumer has placed a clearly written ban not to place them.</p> <p>2. It shall be forbidden to distribute the materials at home when there is no adequate place for them.</p> <p>3. It shall be forbidden to distribute leaflets in vehicles.</p>	<p>sandučićima ili na vratima, ukoliko je potrošač stavio jasno napisanu zabranu da se ne postave.</p> <p>2. Zabranjeno je distribucija materijala u kući ako ne postoji adekvatno mesto za takav materijal.</p> <p>3. Zabranjena je distribucija letaka na vozilima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Mbrojtja e posaçme për te miturit</p> <p>1. Ndalohet shitja, shërbimi dhe dhurimi i pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe duhanit, personave nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.</p> <p>2. Në rast dyshimi që konsumatori është person nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, tregtari nuk duhet ta shesë ose të shërbejë pije alkoolike, pije energjike dhe duhanit, derisa konsumatori nuk e vërteton moshën me një letërnjoftim, pasaportë ose patentë shoferi. Shitja, reklamimi dhe ekspozimi i pijeve energjike për fëmijët rregullohet me ligj të veçantë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Special protection for minors</p> <p>1. Selling, serving and offering alcoholic beverages and tobacco shall be forbidden for persons under the age of eighteen (18).</p> <p>2. In case of doubt that the consumer is a person under the age of eighteen (18), the trader shall not be obliged to sell or serve alcoholic beverages and tobacco, until the consumer proves the age with an identity card, passport or driver's license. The sale, advertising and display of energy drinks for children is regulated by a specific law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Posebna zaštita maloletnika</p> <p>1. Zabranjena je prodaja, posluživanje i poklanjanje alkoholnih pića i cigareta licima mlađim od osamnaest (18) godina.</p> <p>2. U slučaju sumnje da je potrošač lice mlađe od osamnaest (18) godina, trgovac ne treba da prodaje ili služi alkoholna pića i cigarete, sve dok potrošač ne potvrdi godine putem lične karte, pasoša ili vozačke dozvole. Prodaja, oglašavanje i izlaganje energetskih napitaka za decu uređen je posebnim zakonom.</p>

KREU III ETIKETIMI, PAKETIMI DHE DEKLARACIONI I MALLIT	CHAPTER III LABELLING, PACKAGING AND DECLARATION OF THE COMMODITY	GLAVA III ETIKETIRANJE, PAKOVANJE I DEKLARACIJA ROBE
<p>2. Një kusht duhet gjithmonë të konsiderohet si i panegociuar kur hartohet në mënyrë individuale paraprakisht nga shitësi apo furnizuesi, dhe për këtë konsumatori nuk ka qenë në gjendje të ndikojë në përmbajtjen e kushtit, veçanërisht në kontekstin e një kontrate standarde të parapërgatitur.</p> <p>3. Fakti që disa aspekte të një kushti ose një kusht specifik është negociuar në baza individuale, nuk e përjashtojnë zbatimin e këtij neni në pjesën tjetër të kontratës, nëse një vlerësim i përgjithshëm i kontratës tregon se ajo është megjithatë një kontratë standarde e parapërgatitur.</p> <p>4. Aty ku ndonjë shitës apo furnizues pohon se një kusht standard është negociuar në mënyrë individuale, barra e provës në këtë drejtim do të mbetet mbi të.</p>	<p>2. A term shall always be regarded as not individually negotiated where it has been drafted in advance by the seller or supplier, and the consumer has therefore not been able to influence the substance of the term, particularly in the context of a pre-formulated standard contract.</p> <p>3. The fact that certain aspects of a term or one specific term have been individually negotiated shall not exclude the application of this Article to the rest of a contract if an overall assessment of the contract indicates that it is nevertheless a pre-formulated standard contract.</p> <p>4. Where any seller or supplier claims that a standard term has been individually negotiated, the burden of proof in this respect shall be incumbent on him.</p>	<p>2. Uslov se uvek treba smatrati kao nepregovaračkim kada se izradi individualno unapred od strane prodavca ili dobavljača, i stoga potrošač nije bio u stanju da utiče na sadržaj uslova, posebno u kontekstu unapred pripremljenog standardnog ugovora.</p> <p>3. Činjenica da se nekoliko aspektat uslova ili jedan specifičan uslov pregovaran na individualnim osnovama, ne isključuju sprovođenje ovog člana na ostali deo ugovora, ako ukupna procena ugovora pokazuje da je ipak unapred pripremljeni standardni ugovor.</p> <p>4. Tamo gde neki prodavac ili dobavljač tvrdi da je standardni uslov prigovaran individualno, teret dokazivanja u tom pravcu će ostati na njega.</p>
<p>Neni 73 Kushtet të cilat konsiderohen si të padrejta në kontratë</p>	<p>Article 73 Conditions regarded as unfair in the contract</p>	<p>Član 73 Uslovi koji se u ugovoru smatraju nepravičnim</p>
<p>1. Kushtet të cilat konsiderohen si të padrejta janë ato kushte të cilat kanë qëllimin apo efektin e:</p> <p>1.1. Përjashtimit ose kufizimit të përgjegjësisë ligjore të shitësit apo furnizuesit, për shkak të vdekjes së konsumatorit ose lëndimeve personale të këtij të fundit si rezultat i një veprimi ose mosveprimi të atij shitësi apo furnizuesi;</p>	<p>1. Conditions regarded as unfair shall pose terms which have the object or effect of:</p> <p>1.1. Excluding or limiting the legal liability of a seller or supplier in the event of the death of a consumer or personal injury to the latter resulting from an act or omission of that seller or supplier;</p>	<p>1. Uslovi koji se smatraju kao nepravičnim su oni uslovi koji imaju cilj ili efekat:</p> <p>1.1. Isključenja ili ograničenja zakonske odgovornosti prodavca ili dobavljača, zbog smrti potrošača ili ličnih povreda ovog zadnjeg kao rezultat činjenja ili nečinjenja tog prodavca ili dobavljača;</p>

<p>1.2. Përjashtimit ose kufizimit të padrejtë të të drejtave ligjore të konsumatorit përballë shitësit, furnizuesit apo palës tjetër në rast të mos përmbushjes së plotë apo të pjesshme ose të pamjaftueshme nga shitësit apo furnizuesit të çdo detyrimi kontraktuar, duke përfshirë të drejtën e zgjedhjes së kompensimit të një borxhi ndaj shitësit apo furnizuesit kundrejt çdo pretendimi që konsumatori mund të ketë kundër tij;</p> <p>1.3. Arritjes së një marrëveshje që është detyruese për konsumatorin, ndërsa ofrimi i shërbimeve nga shitësi ose ofruesi i nënshtrohet një kushti realizimi i të cilit varet vetëm nga vullneti i tij;</p> <p>1.4. Lejimit të shitësit apo furnizuesit të mbajnë shumat e paguara nga konsumatori, kur ky i fundit vendos të mos e lidh ose përmbush kontratën, pa i ofruar konsumatorit të marrë kompensim të një shume ekuivalente nga shitësit apo furnizuesit kur ky i fundit është pala e cila e anulon kontratën;</p> <p>1.5. Parashtrimin të kërkesës nga konsumatori i cili nuk arrin të përmbushë detyrimin e tij që të paguaj një shumë joproportionalisht të lartë si kompensim;</p>	<p>1.2. Inappropriately excluding or limiting the legal rights of the consumer vis-à-vis the seller or supplier or another party in the event of total or partial non-performance or inadequate performance by the seller or supplier of any of the contractual obligations, including the option of offsetting a debt owed to the seller or supplier against any claim which the consumer may have against him/her;</p> <p>1.3. Making an agreement binding on the consumer whereas provision of services by the professional is subject to a condition whose realisation depends on his own will alone;</p> <p>1.4. Permitting the seller or supplier to retain sums paid by the consumer where the latter does not conclude the contract or withdraws from it, without providing the right for the consumer to demand the compensation of an equivalent amount from sellers or suppliers when the latter fails to conclude or withdraws from the contract;</p> <p>1.5. Requiring any consumer who fails to fulfil his obligation to pay a disproportionately high compensation;</p>	<p>1.2. Nepravilnog isključenja ili ograničenja zakonskih prava potrošača u odnosu na prodavca, dobavljača ili druge strane u slučaju potpunog neispunjenja ili delimičnog ili nedovoljnog ispunjenja od prodavca ili dobavljača svake ugovorene obaveze, uključujući pravo na izbor naknade duga prema prodavcu ili dobavljaču u odnosu na svaku tvrdnju koju potrošač može imati protiv njega;</p> <p>1.3. Postizanja sporazuma koji je obavezujući za potrošača, dok pružanje usluga od prodavca ili pružaoca podleže uslovu čija realizacija zavisi samo od njegove volje;</p> <p>1.4. Dozvoljavanja prodavcu ili dobavljaču da zadrže plaćene iznose od potrošača, kada ovaj zadnji odluči da ne zaključi ili ispuni ugovor, nepružajući potrošaču da uzme naknadu ekvivalentnog iznosa od prodavca ili dobavljača kada je ovaj zadnji strana koja poništava ugovor;</p> <p>1.5. Podnošenja zahteva od potrošača koji ne uspe ispuniti svoju obavezu da plati nesrazmerno visok iznos kao naknadu;</p>
--	--	---

<p>1.6. Autorizimit të shitësit apo furnizuesit të zgjidhë kontratën në bazë diskrecionale, ndërsa e njëjta mundësi nuk i ofrohet konsumatorit, apo i lejohet shitësit apo furnizuesit të mbajnë shumat e paguara për shërbimet që nuk janë ofruar, kur është shitësi apo vetë furnizuesi i cili e zgjidh kontratën;</p> <p>1.7. Mundësimin të shitësit apo furnizuesit të ndërpresë kontratën me kohëzgjatje të pacaktuar, pa njoftim të arsyeshëm, përveç kur ka arsye serioze për ta bërë këtë;</p> <p>1.8. Vazhdimin automatik të kontratës me afat të caktuar kur konsumatori nuk tregon të kundërtën, në rastet kur afati i caktuar që konsumatori të shpreh dëshirën për mos zgjatje të kontratës është i shkurtër në mënyrë të paarsyeshme;</p> <p>1.9. Detyrimin të përvokueshëm të konsumatorit me kushtet të cilat ai nuk kishte asnjë mundësi reale që t'i njoh para lidhjes së kontratës;</p> <p>1.10. Mundësimin të shitësit apo furnizuesit të ndryshoj kushtet e kontratës në mënyrë të njëanshme, pa një arsye të vlefshme e cila është e specifikuar në kontratë;</p>	<p>1.6. Authorising the seller or supplier to dissolve the contract where the same facility is not granted to the consumer, or permitting the seller or supplier to retain the sum paid by the consumer for services not yet supplied, where it is the professional himself who dissolves the contract;</p> <p>1.7. Enabling the seller or supplier to terminate a contract of indeterminate duration without reasonable notice except where there are serious grounds for doing so;</p> <p>1.8. Automatically extending a contract of fixed duration where the consumer does not indicate otherwise when the deadline fixed for the consumer to express this desire not to extend the contract is unreasonably early;</p> <p>1.9. Irrevocably binding the consumer to terms with which he had no real opportunity of becoming acquainted before the conclusion of the contract;</p> <p>1.10. Enabling the seller or supplier to alter the terms of the contract unilaterally without a valid reason which is specified in the contract;</p>	<p>1.6. Ovlašćenja prodavca ili dobavljača da raskine ugovor na diskrecionoj osnovi, dok se potrošaču ne pruža ista mogućnost, ili dozvoljava se prodavcu ili dobavljaču da zadrže iznose plaćene za usluge koje nisu pružene, kada je prodavac ili sam dobavljač koji raskine ugovor;</p> <p>1.7. Omogućavanja prodavcu ili dobavljaču da raskine ugovor na neodređeno vreme, bez razumnog obaveštenja, osim kada ima ozbiljne razloge da to učini;</p> <p>1.8. Automatskog produženja ugovora na određeno vreme kada potrošač ne naznači suprotno, u slučajevima kada je rok određen da potrošač izrazi želju za neprodužavanje ugovora kratak na nerazuman način;</p> <p>1.9. Neopozive obaveze potrošača sa uslovima koje on nije imao nikakvu realnu mogućnost da ih zna pre zaključenja ugovora;</p> <p>1.10. Omogućavanja prodavcu ili dobavljaču da menja uslove ugovora na jednostrani način, bez valjanog razloga koji je naveden u ugovoru;</p>
---	--	--

<p>1.11. Mundësimit të shitësit ose furnizuesit të ndryshoj në mënyrë të njëanshme ndonjë nga karakteristikat e produktit ose shërbimit të ofruar, pa një arsye të vlefshme;</p> <p>1.12. Ofrimit që çmimi i mallrave të përcaktohet në kohën e dorëzimit, apo t'i lejoj një shitësi të mallrave apo furnizuesi të shërbimeve të rris çmimin pa i dhënë konsumatorit të drejtën përkatëse, në të dyja rastet, që të anuloj kontratën nëse çmimi përfundimtar është shumë i lartë në krahasim me çmimin e rënë dakord kur është lidhur kontrata;</p> <p>1.13. Duke i dhënë shitësit apo furnizuesit të drejtën që të përcaktoj nëse mallrat ose shërbimet e ofruara janë në përputhje me kontratën, ose duke i dhënë atij të drejtën ekskluzive për të interpretuar secilin nga termet e kontratës;</p> <p>1.14. Kufizimit të detyrimit të shitësit ose ofruesit që të respektoj angazhimet e marra nga agjentët e tij ose që të angazhohet në pajtueshmëri me një formalitet të veçantë;</p> <p>1.15. Detyrimit të konsumatorit që të përmbushë të gjitha detyrimet e tij kur shitësi ose furnizuesi nuk i përmbush obligimet e tij;</p>	<p>1.11. Enabling the seller or supplier to alter unilaterally without a valid reason for any characteristics of the product or service to be provided;</p> <p>1.12. Providing for the price of goods to be determined at the time of delivery or allowing a seller of goods or supplier of services to increase their price without in both cases giving the consumer the corresponding right to cancel the contract if the final price is too high in relation to the price agreed when the contract was concluded;</p> <p>1.13. Giving the seller or supplier the right to determine whether the goods or services supplied are in conformity with the contract, or giving him the exclusive right to interpret any term of the contract;</p> <p>1.14. Limiting the seller's or supplier's obligation to comply with the commitments undertaken by his agents or making his/her commitments subject to compliance with a particular formality;</p> <p>1.15. Obliging the consumer to fulfil all his/her obligations where the seller or supplier does not perform his/her obligations;</p>	<p>1.11. Omogućavanja prodavcu ili dobavljaču da menja na jednostrani način neke od karakteristika ponuđenog proizvoda ili usluge, bez valjanog razloga;</p> <p>1.12. Pružanja da se cenu robe utvrdi za vreme isporuke, ili da dozvoli prodavcu robe ili dobavljaču usluga da poveća cenu bez davanja odgovarajućeg prava potrošaču, u oba slučaja, da poništi ugovor ako je konačna cena previsoka u odnosu na cenu dogovorenu kada je zaključen ugovor;</p> <p>1.13. Dajući prodavcu ili dobavljaču pravo da utvrdi da li su pružena roba ili usluge u skladu sa ugovorom, ili dajući mu ekskluzivno pravo da tumači svaki od uslova ugovora;</p> <p>1.14. Ograničavanja obaveze prodavca ili dobavljaču da poštuje preuzeta angažovanja od svojih agenta ili da se angažuje u skladu sa posebnom formalnošću;</p> <p>1.15. Obavezivanja potrošača da ispuni sve svoje obaveze kada prodavac ili dobavljač ne ispunjava svoje obaveze;</p>
--	---	---

<p>1.16. Mundësimin të shitësit apo furnizuesit për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij të përcaktuara në kontratë, ku kjo mund të shërbejë në zvogëlimin e garancioneve për konsumatorin, pa pëlqimin e këtij të fundit;</p> <p>1.17. Përjashtimit apo pengimit të të drejtës së konsumatorit që të ndërmarrë veprime ligjore ose të ushtrorë ndonjë mjet tjetër juridik, veçanërisht duke i kërkuar konsumatorit që t'i dërgoj mosmarrëveshjet ekskluzivisht në arbitrazhet e pa mbuluar nga dispozitat ligjore, duke kufizuar padrejtësisht dëshmitë në dispozicion të tij ose duke i imponuar barrën e provës, e që sipas ligjit në fuqi, barra e provës duhet të bie mbi një palë tjetër të kontratës.</p>	<p>1.16. Giving the seller or supplier the possibility of transferring his/her rights and obligations under the contract, where this may serve to reduce the guarantees for the consumer, without the latter's agreement;</p> <p>1.17. Excluding or hindering the consumer's right to take legal action or exercise any other legal remedy, particularly by requiring the consumer to take disputes exclusively to arbitration not covered by legal provisions, unduly restricting the evidence available to him/her or imposing on him/her a burden of proof which, according to the applicable law, should lie with another party to the contract.</p>	<p>1.16. Omogućavanja prodavcu ili dobavljaču prenošenje svojih prava i obaveze propisane u ugovoru, pri čemu to može poslužiti na smanjenje garancija za potrošača, bez saglasnosti ovog zadnjeg;</p> <p>1.17. Isključivanja ili ometanja prava potrošača da preduzme zakonske radnje ili vrši neko drugi pravni lek, posebno zahtevajući potrošaču da dostavi nesporazume ekskluzivno u arbitraži nepotkrepljena zakonskim odredbama, ograničavajući nepravedno dokaze na njegovom raspolaganju ili imponirajući teret dokazivanja, a koje prema važećem zakonu, teret dokazivanja treba da spada na drugu stranu ugovora.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 74 Padrejtësia e një kushti kontraktuar</p> <p>1. Padrejtësia e një kushti kontraktuar do të vlerësohet duke marrë parasysh natyrën e mallrave ose shërbimeve për të cilat është lidhur kontrata dhe duke iu referuar të gjitha rrethanave që e përcjellin lidhjen e kontratës në kohën kur lidhet kontrata, dhe në të gjitha kushtet e tjera të asaj kontrate ose të një tjetër kontrate nga e cila varet ajo.</p> <p>2. Vlerësimi i natyrës së padrejtë të kushteve nuk duhet të lidhet as me përkufizimin e çështjes</p>	<p style="text-align: center;">Article 74 The unfairness of a contractual term</p> <p>1. The unfairness of a contractual term shall be assessed, taking into account the nature of the goods or services for which the contract was concluded and by referring, at the time of conclusion of the contract, to all the circumstances attending the conclusion of the contract and to all the other terms of the contract or of another contract on which it is dependent.</p> <p>2. Assessment of the unfair nature of the terms shall relate neither to the definition of the main</p>	<p style="text-align: center;">Član 74 Nepravilan ugovorni uslov</p> <p>1. Nepravilan ugovorni uslov će se proceniti uzimajući u obzir prirodu robe ili usluga za koje je zaključen ugovor i pozivajući se na sve okolnosti koje prate zaključenje ugovora za vreme kada se zaključuje ugovor, i u svim drugim uslovima tog ugovora, ili drugog ugovora od kojeg zavisi on.</p> <p>2. Procena nepravilne prirode uslova ne treba se vezati ni na definisanje glavnog pitanja</p>

<p>kryesore të kontratës por as me përshtatshmërinë e çmimit dhe shpërblimit në njëri anë, në krahasim me shërbimet apo furnizimet e mallrave në këmbim në anën tjetër, për aq sa këto kushte janë në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 75 Gjuha e thjeshtë dhe e kuptueshme të kushteve të kontratës</p> <p>Në rastin e kontratave ku të gjitha ose disa nga kushtet e ofruara për konsumatorin janë në formë të shkruar, këto kushte gjithmonë duhet të hartohen në gjuhën e thjeshtë dhe të kuptueshme. Aty ku ka dyshime rreth një kushti, do të mbizotërojë interpretimi më i favorshëm për konsumatorin. Ky rregull në interpretim nuk zbatohet në kontekst të procedurave të përcaktuara në kapitullin X të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 76 Mbrojtja ligjore nga kushtet e padrejta në kontratë</p> <p>1. Kontratat e lidhura në mes të një konsumatori dhe shitësi apo furnizuesi nuk duhet të përmbajnë asnjë kusht të padrejtë, dhe se kontrata duhet të vazhdojë të lidh ligjërisht palët nëse ajo kontratë mund të ekzistoj pa kushtet e padrejta.</p>	<p>subject matter of the contract nor the adequacy of the price and remuneration, on the one hand, as against the services or goods and supplies in exchange, on the other, in so far as these terms are in plain intelligible language.</p> <p style="text-align: center;">Article 75 Plain and intelligible language of contract terms</p> <p>In the case of contracts where all or certain terms offered to the consumer are in writing, these terms must always be drafted in plain, intelligible language. Where there is doubt about the meaning of a term, the interpretation most favourable to the consumer shall prevail. This rule on interpretation shall not apply in the context of the procedures laid down in Chapter X of this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 76 Legal protection from unfair contract terms</p> <p>1. Unfair terms used in a contract concluded with a consumer by a seller or supplier shall be null, and the contract shall continue to legally bind the parties if it is capable of continuing in existence without the unfair terms.</p>	<p>ugovora, ali ni na prikladnost cene i naknade sa jedne strane, u odnosu na usluge ili nabavku robe u zamenu, sa druge strane, za onoliko koliko su ovi uslovi na jednostavnom i razumljivom jeziku.</p> <p style="text-align: center;">Član 75 Jednostavan i razumljiv jezik ugovornih uslova</p> <p>U slučaju ugovora gde su svi ili neki od uslova pruženih za potrošača u pisanoj formi, ovi uslovi se moraju uvek izraditi na jednostavan i razumljiv jezik. Tamo gde ima sumnje oko jednog uslova, prevladaće najpovoljnije tumačenje za potrošača. Ovo pravilo u tumačenju se ne primenjuje na kontekst postupaka propisanih u Glavi X ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 76 Zakonska zaštita od nepravičnih ugovornih uslova</p> <p>1. Ugovori zaključeni između potrošača i prodavca ili dobavljača ne trebaju sadržati nijedan nepravičan uslov, i da ugovor mora nastaviti vezati zakonski strane ako taj ugovor može postojati bez nepravičnih uslova.</p>
---	---	--

<p>2. Konsumatori nuk humb mbrojtjen e ofruar nga ky ligj në bazë të zgjedhjes së ligjit të një vendi tjetër si ligj i zbatueshëm në kontratë, nëse ky i fundit ka një lidhje të ngushtë me Republikën e Kosovës.</p>	<p>2. The consumer does not lose the protection granted by this Law by virtue of the choice of the law of another country as the law applicable to the contract if the latter has a close connection with the Republic of Kosovo.</p>	<p>2. Potrošač ne gubi zaštitu pruženu iz ovog zakona na osnovu izbora zakona druge zemlje kao primenjivog zakona u ugovoru, ako ovaj zadnji ima uske veze sa Republikom Kosova.</p>
<p>KREU X</p>	<p>CHAPTER X</p>	<p>GLAVA X</p>
<p>PERPUTHSHMERIA ME KONTRATËN</p>	<p>CONFORMITY WITH THE CONTRACT</p>	<p>USAGLAŠENOST SA UGOVOROM</p>
<p style="text-align: center;">Neni 77 Shitja e mallrave të konsumit</p>	<p style="text-align: center;">Article 77 Sale of consumer goods</p>	<p style="text-align: center;">Član 77 Prodaja robe široke potrošnje</p>
<p>Kontratrat për furnizim me mallrat e konsumit që do të prodhohen apo përpunohen, konsiderohen edhe si kontrata të shitjes për qëllimin e këtij ligji.</p>	<p>Contracts for the supply of consumer goods to be manufactured or produced shall also be deemed sale contracts for the purpose of this Law.</p>	<p>Ugovori o nabavci robe široke potrošnje koja će se proizvoditi ili preraditi, smatraju se i kao ugovorima o prodaje za potrebe ovog zakona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 78 Përputhshmëria me kontratën</p>	<p style="text-align: center;">Article 78 Conformity with the contract</p>	<p style="text-align: center;">Član 78 Usaglašenost sa ugovorom</p>
<p>1. Shitësi duhet të dorëzojë mallrat te konsumatori të cilat janë në përputhshmëri me kontratën e shitjes.</p>	<p>1. The seller must deliver goods to the consumers that are in conformity with the contract of sale.</p>	<p>1. Prodavac treba da isporuči robu potrošaču koja je u skladu sa ugovorom o prodaji.</p>
<p>2. Mallrat supozohet të jenë në përputhshmëri me kontratën e shitjes, nëse:</p>	<p>2. The consumable commodities are supposed to be in conformity with the contract of sale if they:</p>	<p>2. Pretpostavlja se da je roba u skladu sa ugovorom o prodaji, ako:</p>
<p>2.1. Janë në pajtim me përshkrimin e dhënë nga shitësi dhe posedojnë cilësitë e mallrave, të cilat shitësi ia ka paraqitur konsumatorit si shembull ose model;</p>	<p>2.1. Comply with the description given by the seller and possess the qualities of commodities which the seller has presented to the consumer as a sample or model;</p>	<p>2.1. Je u skladu su sa opisom datim od prodavca i poseduju odlike robe, koje je prodavac predstavio potrošaču kao primer ili model;</p>

<p>2.2. Janë të përshtatshme për ndonjë qëllim të veçantë, për të cilin i kërkon konsumatori dhe të cilat ia ka bërë me dije shitësit në kohën e lidhjes së kontratës, të cilën shitësi e ka pranuar;</p> <p>2.3. Janë të përshtatshme për qëllimet, për të cilat përdoren zakonisht mallrat e llojit të njëjtë;</p> <p>2.4. Shfaqin cilësinë dhe efektshmërinë, të cilat janë normale për mallrat e llojit të njëjtë dhe të cilat me arsye konsumatori i pret, duke pasur parasysh natyrën e mallrave dhe duke marr parasysh çfarëdo deklarimi publik për karakteristikat e veçanta të mallrave, që bëhet për to nga shitësi, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, veçanërisht gjatë reklamimit apo në etiketim.</p> <p>3. Për qëllime të këtij neni, nuk do të konsiderohet si mungesë përputhshmërie, nëse gjatë kohës së lidhjes së kontratës, konsumatori ishte i vetëdijshëm, ose në mënyrë të arsyeshme nuk ka mund të mos jetë i vetëdijshëm për mungesën e përputhshmërisë, ose nëse mungesa e përputhshmërisë e ka origjinën e vet në materialet e ofruara nga konsumatori.</p> <p>4. Shitësi nuk do të detyrohet nga deklaratat publike, siç parashihet në nënparagrafin 2.4 të paragrafit 2 të këtij neni, nëse ai:</p>	<p>2.2. Are fit for any particular purpose for which the consumer requires them and which he made known to the seller at the time of conclusion of the contract and which the seller has accepted;</p> <p>2.3. Are fit for the purposes for which commodities of the same type are normally used;</p> <p>2.4. Show the quality and performance which are normal in commodities of the same type and which the consumer can reasonably expect, given the nature of the commodities and taking into account any public statements on the specific characteristics of the commodities made about them by the seller, the producer or his representative, particularly in advertising or on labelling.</p> <p>3. For the purposes of this Article, nonconformity shall not be deemed to have occurred if, at the time of the conclusion of the contract, the consumer was not aware, or reasonably could not have been unaware of the non-compliance, or if the non-compliance originates from the materials provided by the consumer.</p> <p>4. The seller shall not be bound by public statements, as referred to in subparagraph 2.4, paragraph 2 of this Article if he/she:</p>	<p>2.2. Je pogodna za neki poseban cilj, za koji potrošač traži i koje je dao do znanja prodavcu za vreme zaključenja ugovora, koji je prodavac prihvatio;</p> <p>2.3. Je pogodna za ciljeve, za koje se obično koristi roba iste vrste;</p> <p>2.4. Pokazuje kvalitet i efektivnost koji su normalne za robu iste vrste i koju potrošač razumno očekuje, imajući u vidu prirodu robe i imajući u vidu svaku javnu izjavu o posebnim karakteristikama robe, koju daje prodavac, proizvođač ili njegov zastupnik, posebno tokom reklamiranja ili u etiketiranju.</p> <p>3. Za potrebe ovog člana, neće se smatrati kao nedostatak usaglašenosti, ako je za vreme zaključenja ugovora, potrošač bio svestan, ili na razuman način nije mogao biti svestan o nedostatku usaglašenosti, ili ako nedostatak usaglašenosti ima svoje poreklo u materijalima pruženih od potrošača.</p> <p>4. Prodavac se neće obavezati javnim izjavama, kako je propisano tačkom 2.4 stav 2. ovog člana, ako on:</p>
--	---	---

<p>4.1. Dëshmon se nuk ishte dhe nuk ka mundur të jetë në mënyrë të arsyeshme i vetëdijshëm për deklaratën në fjalë;</p> <p>4.2. Dëshmon se në kohën e lidhjes së kontratës deklarata ishte korrigjuar, ose;</p> <p>4.3. Dëshmon se vendimi për të blerë mallrat e konsumit nuk mund të ketë qenë i ndikuar nga deklarata.</p> <p>5. Çdo mungesë e përputhshmërisë, që rezulton nga instalimi i gabuar i mallrave të konsumit do të konsiderohet si i barabartë me mungesën e përputhshmërisë të mallrave, nëse instalimi përbënë një pjesë të kontratës së shitjes së mallrave, dhe mallrat janë instaluar nga shitësi ose nën përgjegjësinë e tij. Kjo zbatohet në mënyrë të barabartë edhe në qoftë se produkti, që është menduar të instalohet nga konsumatori, është instaluar nga konsumatori dhe se instalimi i gabuar ndodh për shkak të një të mete në udhëzimet e instalimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 79 Të drejtat e konsumatorit</p> <p>1. Shitësi do të ketë detyrime ndaj konsumatorit për çdo mungesë të përputhshmërisë që ekziston në kohën kur janë dorëzuar mallrat.</p>	<p>4.1. Shows that he/she was not, and could not reasonably have been, aware of the statement concerned;</p> <p>4.2. Shows that by the time of the conclusion of the contract the statement had been corrected, or;</p> <p>4.3. Shows that the decision to buy the consumer goods could not have been influenced by the statement.</p> <p>5. Any lack of conformity resulting from incorrect installation of the consumption commodities shall be deemed to be equivalent to lack of conformity of the commodities if installation forms part of the contract of sale of the commodities and the commodities were installed by the seller or under his responsibility. This shall apply equally if the product, intended to be installed by the consumer, is installed by the consumer and the incorrect installation is due to a shortcoming in the installation instructions.</p> <p style="text-align: center;">Article 79 Consumer rights</p> <p>1. The seller shall be liable to the consumer for any lack of conformity which exists at the time the commodities were delivered.</p>	<p>4.1. Dokaže da nije i nije mogao biti na razuman način svestan o dotičnoj izjavi;</p> <p>4.2. Dokaže da je za vreme zaključenja ugovora izjava ispravljena, ili;</p> <p>4.3. Dokaže da odluka o kupovini robe široke potrošnje nije mogla biti uticana od izjave.</p> <p>5. Svaki nedostatak usaglašenosti, koji rezultira iz pogrešne instalacije roba široke potrošnje smatraće se kao jednakim sa nedostatkom usaglašenosti robe, ako instalacija predstavlja jedan deo ugovora o prodaji robe, a roba je instalirana od strane prodavca ili pod njegovom odgovornošću. Ovo se sprovodi na jednak način i ako proizvod, koji je namenjen da se instalira od potrošača, instaliran je od strane potrošača, te da se pogrešna instalacija događa zbog jednog nedostatka u uputstvima za instalaciju.</p> <p style="text-align: center;">Član 79 Prava potrošača</p> <p>1. Prodavac će imati dužnosti prema potrošaču za svaki nedostatak usaglašenosti koji postoji za vreme isporuke robe.</p>
---	--	---

<p>2. Në rast të mungesës së përputhshmërisë, konsumatori ka të drejtë të kërkojë që mallrat të sillen në përputhshëri, pa pagesë, nëpërmjet riparimit apo zëvendësimit, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, apo të ketë një zbritje të duhur në çmim ose anulim të kontratës në lidhje me këto mallra, në përputhje me paragrafët 6 dhe 7 të këtij neni.</p> <p>3. Në radhë të parë, konsumatori mund të kërkojë nga shitësi të riparojë mallrat ose mund t'i kërkojë shitësit t'i zëvendësojë ato, në cilindo rast pa pagesë, përveç rasteve kur kjo është e pamundur ose jo-proporcionale. Një riparim do të konsiderohet si jo-proporcional nëse imponon kosto mbi shitësin, që në krahasim me rregullimin alternativ është i paarsyeshëm, duke marr parasysh:</p> <p>3.1. Vlerën të cilën do ta kishin mallrat nëse nuk do të kishte mungesë të përputhshmërisë;</p> <p>3.2. Rëndësinë e mungesës së përputhshmërisë, dhe;</p> <p>3.3. Nëse rregullimi alternativ mund të përfundohet pa ndonjë vështirësi domethënëse për konsumatorin.</p> <p>4. Çfarëdo riparimi ose zëvendësimi do të përfundohet brenda një kohe të arsyeshme dhe pa ndonjë shqetësim të konsiderueshëm për konsumatorin, duke pasur parasysh natyrën e</p>	<p>2. In the case of a lack of conformity, the consumer shall be entitled to have the goods brought into conformity, free of charge, by repair or replacement, in accordance with paragraph 3 of this Article, or to have an appropriate reduction made in the price or the contract rescinded with regard to those goods, in accordance with paragraphs 6 and 7 of this Article.</p> <p>3. In the first place, the consumer may require the seller to repair the goods or he may require the seller to replace them, in either case free of charge, unless this is impossible or disproportionate. A remedy shall be deemed to be disproportionate if it imposes costs on the seller which, in comparison with the alternative remedy, are unreasonable, taking into account:</p> <p>3.1. The value of the goods would have if there were no lack of conformity;</p> <p>3.2. The significance of the lack of conformity; and</p> <p>3.3. Whether the alternative remedy could be completed without significant inconvenience to the consumer.</p> <p>4. Any repair or replacement shall be completed within a reasonable time and without any significant inconvenience to the consumer, taking</p>	<p>2. U slučaju nedostatka usaglašenosti, potrošač ima pravo da traži da se roba dovede u usaglašenost, besplatno, kroz popravku ili zamenu, u skladu sa stavom 3. ovog člana, ili da ima odgovarajući popust na cenu ili poništavanje ugovora u vezi sa ovom robom, u skladu sa stavovima 6. i 7. ovog člana.</p> <p>3. Prvenstveno, potrošač može tražiti od prodavca da popravi robu ili može tražiti od prodavca da je zameni, u bilo kom slučaju besplatno, osim slučajevima kada je to nemoguće ili nesrazmerno. Popravak će se smatrati nesrazmernim ako imponira troškove prodavcu, koji u odnosu na alternativno uređenje je neopravdan, uzimajući u obzir:</p> <p>3.1. Vrednost koju bi roba imala ako ne bi bilo nedostatka usaglašenosti;</p> <p>3.2. Važnost nedostatka usaglašenosti, i;</p> <p>3.4. Ako se alternativno uređenje može završiti bez neke značajne poteškoće za potrošača.</p> <p>4. Bilo koja popravka ili zamena završiće se u razumnom roku i bez neke značajne zabrinutosti za potrošača, imajući u vidu</p>
---	--	---

<p>mallrave dhe qëllimin për të cilin konsumatori ka kërkuar mallrat.</p> <p>5. Termat “pa pagesë” në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, aludojnë në kostot e nevojshme që grumbullohen në mënyrë që të sillen mallrat në përputhshmëri, në veçanti koston e postës, punës dhe materialeve.</p> <p>6. Konsumatori mund të kërkojë zbritjen adekuate të çmimit ose anulimin e kontratës:</p> <p>6.1. Nëse konsumatorit nuk i mundësohet rregullimi apo zëvendësimi i produktit, ose;</p> <p>6.2. Nëse shitësi nuk e ka bërë riparimin brenda një kohe të arsyeshme, ose;</p> <p>6.3. Nëse shitësi nuk e ka bërë riparimin e konsiderueshëm për konsumatorin.</p> <p>7. Konsumatori nuk ka të drejtë të anulojë kontratën nëse mungesa e përputhshmërisë është e vogël.</p> <p style="text-align: center;">Neni 80 E drejta në kompensim</p> <p>Aty ku shitësi i fundit është përgjegjës ndaj konsumatorit për shkak të mungesës së përputhshmërisë që rezulton nga një veprim apo</p>	<p>account of the nature of the goods and the purpose for which the consumer required the goods.</p> <p>5. The terms “free of charge” in paragraphs 2 and 3 of this Article shall refer to the necessary costs incurred to bring the goods into conformity, particularly the cost of postage, labour and materials.</p> <p>6. The consumer may require an appropriate reduction of the price or have the contract rescinded:</p> <p>6.1. If the consumer is entitled to neither repair nor replacement of the product, or;</p> <p>6.2. If the seller has not completed the remedy within a reasonable time, or;</p> <p>6.3. If the seller has not completed the remedy without significant inconvenience to the consumer.</p> <p>7. The consumer is not entitled to have the contract rescinded if the lack of conformity is minor.</p> <p style="text-align: center;">Article 80 Right of redress</p> <p>Where the final seller is liable to the consumer because of a lack of conformity resulting from an act or omission by the producer, a previous seller</p>	<p>prirodu robe i svrhu za koju je potrošač zatražio robu.</p> <p>5. Izrazi „besplatno“ u stavovima 2. i 3. ovog člana, aludiraju na potrebne troškove koji se sakupljaju da bi se roba dovela u usaglašenost, posebno poštanski troškovi, troškovi rada i materijala.</p> <p>6. Potrošač može tražiti adekvatno smanjenje cene ili poništenje ugovora:</p> <p>6.1. Ako se potrošaču ne omogući regulisanje ili zamena proizvoda, ili;</p> <p>6.2. Ako prodavac nije izvršio popravku unutar razumnog roka, ili;</p> <p>6.3. Ako prodavac nije izvršio značajnu popravku za potrošača.</p> <p>7. Potrošač nema pravo poništiti ugovor ako je nedostatak usaglašenosti mali.</p> <p style="text-align: center;">Član 80 Pravo na naknadu</p> <p>Tamo gde je krajnji prodavac odgovoran prema potrošaču zbog nedostatka usaglašenosti koji rezultira zbog činjenja ili</p>
---	---	--

<p>mosveprim nga ana e prodhuesit, shitësit të mëparshëm në të njëjtën zinxhir kontratash apo ndërmjetësuesi tjetër, shitësi i fundit ka të drejtë të përdorë mjete kundër personit ose personave përgjegjës në zinxhirin kontraktues përgjegjës për jopërputhshmëri të produktit. Nëse personi përgjegjës për jo-përputhshmëri nuk mund të zbulohet, shitësi i fundit ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim nga personi prej të cilit e ka marr produktin, pavarësisht nëse ky person ka pasur ose është dashur të ketë pasur njohur mbi jopërputhshmërinë në kohën kur shitësi i fundit është pajisur me produktin. Ky detyrim do të mbikëqyret nga rregullat e përgjithshme detyrimore.</p>	<p>in the same chain of contracts or any other intermediary, the final seller shall be entitled to pursue remedies against the person or persons liable in the contractual chain responsible for non-conformity of the product. If the responsible person for non-conformity cannot be revealed, the final seller shall be entitled to claim compensation from the person he received the product, regardless of whether this person has been or should have been aware of the non-conformity at the time when the last seller has been provided with the product. This obligation shall be overseen by general obligatory rules.</p>	<p>nečinjenja proizvođača, prethodnog prodavača u istom lancu ugovora ili drugog posrednika, krajnji prodavac ima pravo da koristi sredstva protiv lica ili odgovornih lica u lancu ugovaranja odgovorna za neusaglašenost proizvoda. Ako se odgovorno lice za neusaglašenost ne može otkriti, krajnji prodavac ima pravo tražiti odštetu od lica od kojeg je primio proizvod, bez obzira da li je to lice imalo ili je trebalo znati o neusaglašenosti u vremenu kada se krajnji prodavač opremio proizvodom. Ova obaveza će se nadgledati od opštih obligacionih pravila.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 81 Afatet kohore</p>	<p style="text-align: center;">Article 81 Time limits</p>	<p style="text-align: center;">Član 81 Vremenski rokovi</p>
<p>1. Shitësi do të jetë përgjegjës sipas nenit 79 të këtij ligji, kur mungesa e përputhshmërisë bëhet e dukshme brenda dy (2) viteve pas dorëzimit të të mirave.</p> <p>2. Në mënyrë që të përfitojë nga të drejtat e tij, konsumatori duhet të njoftojë shitësin për mungesën e përputhshmërisë brenda një periudhe prej dy (2) muajsh nga data kur ai e ka zbuluar mungesën e tillë të përputhshmërisë.</p> <p>3. Përveç nëse përcaktohet ndryshe, çdo mungesë e përputhshmërisë që del në pah brenda gjashtë (6)</p>	<p>1. The seller shall be held liable under Article 79 of this Law, where the lack of conformity becomes apparent within two (2) years from the delivery of the goods.</p> <p>2. In order to benefit from his rights, the consumer must inform the seller of the lack of conformity within a period of two (2) months from the date on which he detected such lack of conformity.</p> <p>3. Unless proved otherwise, any lack of conformity which becomes apparent within six</p>	<p>1. Prodavac biće odgovoran prema članu 79. ovog zakona, kada nedostatak usaglašenosti postane očigledan u roku od dve (2) godine nakon isporuke dobara.</p> <p>2. Kako bi iskoristio od svoja prava, potrošač treba obavestiti prodavca o nedostatku usaglašenosti unutar perioda od dva (2) meseca od datuma kada je on otkrio takav nedostatak usaglašenosti.</p> <p>3. Osim ako se drugačije utvrdi, svaki nedostatak usaglašenosti koji postane</p>

<p>muajve nga dorëzimi i mallrave, do të merret se ka ekzistuar në kohën e dorëzimit, përveç nëse ky supozim është në papajtueshmëri me natyrën e mallit ose me natyrën e mungesës së përputhshmërisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 82 Garancitë</p> <p>1. Garancia do të jetë ligjërisht detyruese për ofertuesin sipas kushteve të caktuara në deklaratën e garancisë dhe reklamimin e ndërlidhur.</p> <p>2. Garancia do të:</p> <p>2.1. Përcaktojë se konsumatori ka të drejta ligjore sipas legjislacionit të zbatueshëm vendor, që rregullon shitjen e mallrave të konsumit dhe ta bëjë të qartë se ato të drejta nuk ndikohen nga garancia;</p> <p>2.2. Përshkruajë me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme përmbajtjet e garancisë dhe të dhënat thelbësore për t'u mbështetur në garanci, veçanërisht kohëzgjatjen dhe shtrirjen territoriale të garancisë, si dhe emrin dhe adresën e garantuesit;</p> <p>2.3. Afati i riparimit të produktit i cili nuk është në përputhshmëri me kontratën sipas paragrafit</p>	<p>(6) months of delivery of the goods shall be presumed to have existed at the time of delivery unless this presumption is incompatible with the nature of the goods or the nature of the lack of conformity.</p> <p style="text-align: center;">Article 82 Guarantee</p> <p>1. A guarantee shall be legally binding on the offerer under the conditions laid down in the guarantee statement and the associated advertising.</p> <p>2. The guarantee shall:</p> <p>2.1. State that the consumer has legal rights under applicable national legislation governing the sale of consumer goods and make clear that those rights are not affected by the guarantee;</p> <p>2.2. Set out in plain intelligible language the contents of the guarantee and the essential particulars necessary for making claims under the guarantee, notably the duration and territorial scope of the guarantee as well as the name and address of the guarantor;</p> <p>2.3. The deadline for the repair of the product which is not in conformity with the contract period according to paragraph 2 of Article 79</p>	<p>očigledan u roku od šest (6) meseci od isporuke robe, uzeće se da je postojao u vreme isporuke, osim ako takva pretpostavka nije u skladu sa prirodom robe ili prirodom nedostatka usaglašenosti.</p> <p style="text-align: center;">Član 82 Garancije</p> <p>1. Garancija će biti pravno obavezujuća za pružaoca prema uslovima navedenim u izjavi o garanciji i povezanim reklamiranjem.</p> <p>2. Garancija će:</p> <p>2.1. Utvrditi da potrošač ima zakonska prava prema primenjivim domaćim zakonodavstvom koje uređuje prodaju robe široke potrošnje i učiniti jasnim da na ta prava ne utiče garancija;</p> <p>2.2. Opisati jednostavnim i razumljivim jezikom sadržaje garancije i osnovne podatke da se može osloniti na garanciju, posebno trajanje i teritorijalnu rasprostranjenost garancije, kao i ime i adresu davaoca garancije;</p> <p>2.3. Rok popravke proizvoda koji nije u skladu sa ugovorom prema stavu 2. člana</p>
---	--	---

<p>2 të nenit 79 të këtij ligji nuk mund të tejkaloj periudhën tridhjetë ditë (30) kalendarike.</p> <p>3. Me kërkesën e konsumatorit, garancia do të jetë në dispozicion me shkrim ose e paraqitur në ndonjë medium tjetër afatgjatë, që është i qasshëm për të.</p> <p>4. Duhet të sigurohet që garancia të hartohet në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës sipas përzgjedhjes së konsumatorit.</p> <p>5. Nëse një garanci do të shkelë kërkesat e parapara në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, vlefshmëria e kësaj garancie në një mënyrë nuk duhet të ndikohet dhe konsumatori mund të vazhdoj të mbështetet në garanci dhe kërkojë respektimin e saj.</p>	<p>of this Law shall not exceed thirty (30) calendar days.</p> <p>3. On request by the consumer, the guarantee shall be made available in writing or featured in another durable medium available and accessible to him.</p> <p>4. The guarantee shall be drafted in the official Albanian language that does not exclude other official languages in the Republic of Kosovo.</p> <p>5. Should a guarantee infringe the requirements of paragraphs 2, 3 and 4 of this Article, the validity of this guarantee shall in no way be affected, and the consumer can still rely on the guarantee and require that it be respected.</p>	<p>79 .ovog zakona ne može prekoračiti period od trideset (30) kalendarskih dana.</p> <p>3. Na zahtev potrošača, garancija će biti na raspolaganju pismeno ili predstavljena na neki drugi održivi medij, koji je dostupan za njega.</p> <p>4. Treba obezbediti da se garancija izradi na jednom od službenih jezika Republike Kosova prema izboru potrošača.</p> <p>5. Ako će jedna garancija kršiti uslove propisane stavovima 2, 3. i 4. ovog člana, na važenje ove garancije ne treba se uticati na jedan način i potrošač može nastaviti da se oslanja na garanciju i zahteva njeno poštovanje.</p>
<p>Neni 83 Karakter i detyrim</p>	<p>Article 83 Binding nature</p>	<p>Član 83 Priroda obaveze</p>
<p>1. Çdo kusht ose marrëveshje kontraktuale e lidhur me shitësin para se mungesa e përputhshmërisë të bie në vëmendje të shitësit e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë heq ose kufizon të drejtat që rezultojnë prej këtij kapitulli të këtij ligji, nuk do të jetë obliguese për konsumatorin.</p> <p>2. Në rastin e mallrave të dorës së dytë, shitësi dhe konsumatori mund të pajtohen për kushtet dhe marrëveshjet kontraktuale, që kanë periudhë më të</p>	<p>1. Any contractual terms or agreements concluded with the seller before the lack of conformity is brought to the seller's attention which directly or indirectly waive or restrict the rights resulting from this Chapter of this Law shall not be binding on the consumer.</p> <p>2. In the case of second-hand goods, the seller and consumer may agree on contractual terms or agreements which have a shorter time period for</p>	<p>1. Svaki uslov ili ugovorni sporazum zaključen sa prodavcem pre nego što se nedostatak usaglašenosti stavi doznanja prodavcu koji na direktan ili indirektan način uklanja ili ograničava prava koja rezultiraju iz ove glave ovog zakona, neće biti obavezujući za potrošača.</p> <p>2. U slučaju polovne robe, prodavac i potrošač se mogu složiti o uslovima i ugovornim sporazumima, koji imaju kraći period obaveze</p>

<p>shkurtër të obligimit të shitësit sesa ajo që përcaktohet në paragrafin 1, të nenit 81 të këtij ligji. Kjo periudhë nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 84 Mbrojta minimale</p> <p>Të drejtat, që dalin nga ky ligj do të ushtrohen pa ndonjë paragjykim për të drejtat tjera, në të cilat konsumatori mund të thirret sipas rregullave të përgjithshme që rregullojnë detyrimet kontraktuale dhe jo-kontraktuale.</p> <p>KREU XI</p> <p>MARRËVESHJET E KREDIVE PËR KONSUMATORË</p> <p style="text-align: center;">Neni 85 Marrëveshjet e kredive për konsumatorë</p> <p>1. Dispozitat e këtij ligji nuk do të zbatohen për:</p> <p>1.1. Marrëveshjet Hipotekare Rezidenciale të lëshuara sipas Rregullores së BQK-së për Kreditë Hipotekare Rezidenciale;</p> <p>1.2. Marrëveshjet e qirasë ose lizingut ku detyrimi për të blerë objektin e marrëveshjes nuk është përcaktuar as nga vetë marrëveshja e</p>	<p>the liability of the seller than that set down in paragraph 1 of Article 8 of this Law. Such a period may not be less than one (1) year.</p> <p style="text-align: center;">Article 84 Minimal protection</p> <p>The rights resulting from this Law shall be exercised without prejudice to other rights which the consumer may invoke under the general rules governing contractual or non-contractual liability.</p> <p>CHAPTER XI</p> <p>CONSUMER CREDIT AGREEMENTS</p> <p style="text-align: center;">Article 85 Consumer credit agreements</p> <p>1. The provisions of this law shall not apply to:</p> <p>1.1. Residential Mortgage Agreements issued under the CBK Regulation on Residential Mortgage Lending;</p> <p>1.2. Hiring or leasing agreements where an obligation to purchase the object of the agreement is not laid down either by the</p>	<p>prodavca od one koja je propisana stavom 1. člana 81. ovog zakona. Ovaj period ne može biti kraći od jedne (1) godine.</p> <p style="text-align: center;">Član 84 Minimalna zaštita</p> <p>Prava koja proizilaze iz ovog zakona vršiće se bez nekog prejudiciranja o drugim pravima, na koja se potrošač može pozvati prema opštim pravilima koja uređuju ugovorne i neugovorne obaveze.</p> <p>GLAVA XI</p> <p>UGOVORI O POTROŠAKIM KREDITIMA</p> <p style="text-align: center;">Član 85 Ugovori o potrošačkim kreditima</p> <p>1. Odredbe ovog zakona neće se primeniti na:</p> <p>1.1 Ugovore o hipoteci na stan izdati prema Uredbi CBK-a za stambene hipotekarne kredite;</p> <p>1.2 Ugovore o zakupu ili lizingu gde obaveza za kupovinu objekta ugovora nije utvrđena ni samim ugovorom, niti nekim</p>
---	--	---

<p>1. Përveç mjeteve juridike në dispozicion të konsumatorit sipas ligjit përkatës për të Drejtat Detyrimore, në rast të shkeljes së dispozitave të kontratës, konsumatori ka në dispozicion periudhën prej katërbëdhjetë (14) ditëve kalendarike për t'u tërhequr nga kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit, pa dhënë ndonjë arsye.</p> <p>2. Periudha e tërheqjes duhet të llogaritet:</p> <p>2.1. Nga dita e përmbylljes së kontratës apo ndonjë kontrate të detyrueshme paraprake, apo;</p> <p>2.2. Nga dita kur konsumatori pranon kontratën apo ndonjë kontratë të detyrueshme paraprake nëse është më vonë se sa data e paraparë në nënparagrafin 2.1 të këtij neni.</p> <p>3. Periudha e tërheqjes duhet të skadojë:</p> <p>3.1. Pas një (1) viti dhe katërbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga dita e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, ku një formular standard i veçantë</p>	<p>1. In addition to the remedies available to the consumer under the Law on Obligational Relationships, in the event of a breach of the provisions of the contract, the consumer is given a period of fourteen (14) calendar days to withdraw from the timeshare, long-term holiday, resale or exchange contract, without giving any reason.</p> <p>2. The withdrawal period shall be calculated:</p> <p>3.1. From the day of the conclusion of the contract or of any binding preliminary contract; or</p> <p>3.2. From the day the consumer receives the contract or any binding preliminary contract if it is later than the date referred to in subparagraph 2.1 of this Article.</p> <p>3. The withdrawal period shall expire</p> <p>3.1. After one (1) year and fourteen (14) calendar days from the day referred to in paragraph 2 of this Article of this Law, where</p>	<p>1. Pored pravnih lekova dostupnih potrošaču prema relevantnom zakonu o obligacionom pravima, u slučaju kršenja odredbi ugovora, potrošaču je na raspolaganju rok od četrnaest (14) kalendarskih dana da odustane od ugovora za korišćenje nepokretnosti na određeno vreme u svrhu odmora, dugoročnog korišćenja proizvoda za odmor, preprodaju i zamenu, bez navođenja razloga.</p> <p>2. Period odustanka treba izračunati:</p> <p>2.1. Od dana zaključenja ugovora ili nekog prethodnog obavezujućeg ugovora, ili;</p> <p>2.2. Od dana kada potrošač prihvati ugovor ili bilo koji prethodni obavezujući ugovor ako je to kasnije od datuma predviđanog u tački 2.1 ovog člana.</p> <p>3. Period odustanka mora da istekne:</p> <p>3.1. Nakon jedne (1) godine i četrnaest (14) kalendarskih dana od dana navedenog u stavu 2. ovog člana, kada trgovac nije</p>

<p>i tërheqjes siç kërkohet nga paragrafi 3 i nenit 109 të këtij ligji nuk është plotësuar nga tregtari dhe i ofrohet konsumatorit me shkrim, në letër ose në një medium tjetër të qëndrueshëm;</p> <p>3.2. Pas tre (3) muajsh dhe katërbëdhjetë (14) ditëve kalendrike nga dita e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, ku informacionet e parapara në paragrafin 2 të nenit 105 të këtij ligji, përfshirë formularin standard për informim që do të përcaktohen me akt nënligjor sipas paragrafit 2 të nenit 105 të këtij ligji, nuk i janë dhënë konsumatorit me shkrim, në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm.</p> <p>4. Pasi të jetë plotësuar nga tregtari formulari standard që do të përcaktohet me akt nënligjor për tërheqje ashtu siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 105 të këtij ligji dhe i është përcjell konsumatorit me shkrim, në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm, brenda një viti nga dita e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, periudha e tërheqjes do të fillojë nga dita kur konsumatori të ketë pranuar atë formular. Në të njëjtën mënyrë të përafërt, kur informacioni i paraparë në paragrafin 1 të nenit 109 të këtij ligji, përfshirë formularin standard të informimit që do të përcaktohet me akt nënligjor sipas paragrafit 2 të nenit 105 të këtij ligji, i është ofruar konsumatorit me shkrim, në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm, brenda tre (3)</p>	<p>a separate standard withdrawal form as required by paragraph 3 of Article 109 of this Law has not been filled in by the trader and is provided to the consumer in writing, on paper or on another durable medium;</p> <p>3.2. After three (3) months and fourteen (14) calendar days from the day referred to in paragraph 2 of this Article, where the information referred to in paragraph 2 of Article 105 of this Law, including the standard information form to be set by a sub-legal act pursuant to paragraph 2 of Article 105 of this Law, which has not been provided to the consumer in writing, on paper or on another durable medium.</p> <p>4. Where a standard withdrawal form as required by paragraph 2 of Article 105 of this Law has been filled in by the trader and provided to the consumer in writing, on paper or on another durable medium, within one year from the day referred to in paragraph 2 of this Article, the withdrawal period shall start from the day the consumer receives that form. Similarly, where the information referred to in paragraph 1 of Article 109 of this Law, including the standard information form to be set by a sub-legal act pursuant to paragraph 2 of Article 10 of this Law, has been provided to the consumer in writing, on paper or another durable medium, within three (3) months from the day referred to in paragraph 2 of</p>	<p>popunio poseban standardni obrazac za odustanak u skladu sa stavom 3. člana 109. ovog zakona i dostavljeno potrošaču u pisanoj formi, na papiru ili na drugom trajnom mediju;</p> <p>3.2. Nakon tri (3) meseca i četrnaest (14) kalendarskih dana od dana predviđenog iz stava 2. ovog člana, kada informacije predviđene iz stava 2. člana 105. ovog zakona, uključujući i standardni obrazac za informacije koje će se utvrditi podzakonskim aktom iz stava 2. člana 105. ovog zakona, nisu date potrošaču u pisanoj formi, na papiru ili drugom trajnom mediju.</p> <p>4. Nakon što trgovac popuni standardni obrazac koji će podzakonskim aktom biti određen za odustanak u skladu sa stavom 2 člana 105 ovog zakona i bude prosleđen potrošaču u pisanoj formi, na papiru ili drugom trajnom mediju, u roku od godinu dana od dana predviđanog iz stava 2. ovog člana, rok za odustanak počinje da teče od dana kada potrošač prihvati taj obrazac. Na isti približan način, kada informacije predviđene iz stava 1. člana 109. ovog zakona, uključujući i standardni obrazac informacija koji će biti utvrđen podzakonskim aktom prema stavu 2. člana 105. ovog zakona, dostavljene potrošaču u pisanoj formi, na papiru ili na drugom</p>
---	---	---

<p>muajve nga dita e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, periudha e tërheqjes do të fillojë nga dita kur konsumatori të ketë pranuar informacionin.</p> <p>5. Në rast se kontrata e shkëmbimit i ofrohet në të njëjtën kohë konsumatorit së bashku me kontratën e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, atëherë në të dy kontratat zbatohet një periudhë e vetme e tërheqjes në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni. Periudha e tërheqjes për të dy kontratat do të llogaritet në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni pasi ato zbatohen për kontratën e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 111 Modalitetet për ushtrimin e së drejtës për tërheqje të kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit</p> <p>Kur konsumatori ka për qëllim të ushtrojë të drejtën e tërheqjes, konsumatori duhet, para skadimit të periudhës së tërheqjes, të njoftoi tregtarin në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm për vendimin për t'u tërhequr. Konsumatori mund të përdorë standardin me formën që do të përcaktohet me akt nënligjor sipas paragrafit 2 të nenit 105 të këtij ligji të ofruar nga tregtari në përputhje me paragrafin 1 të nenit 109 të këtij ligji. Konsiderohet</p>	<p>this Article, the withdrawal period shall start from the day the consumer receives such information.</p> <p>5. In the event that the exchange contract is offered to the consumer together with and at the same time as the timeshare contract, only a single withdrawal period in accordance with paragraph 1 of this Article shall apply to both contracts. The withdrawal period for both contracts shall be calculated according to the provisions of paragraph 2 of this Article as they apply to the timeshare contract.</p> <p style="text-align: center;">Article 111 Modalities for exercising the right of withdrawal from timeshare, long-term holiday product, resale and exchange contracts</p> <p>Where the consumer intends to exercise the right of withdrawal, the consumer shall, before the expiry of the withdrawal period, notify the trader on paper or on another durable medium of the decision to withdraw. The consumer may use the standard withdrawal form to be set by a bylaw pursuant to paragraph 2 of Article 105 of this Law provided by the trader in accordance with paragraph 1 of Article 109 of this Law. The</p>	<p>trajnom mediju, u roku od tri (3) meseca od dana iz stava 2. ovog člana, rok za odustanak počinje da teče od dana kada je potrošač primio informaciju.</p> <p>5. U slučaju da se ugovor o razmeni ponudi potrošaču istovremeno sa ugovorom o korišćenju nepokretnosti na određeno vreme u svrhu odmora, tada se za oba ugovora primenjuje jedinstveni rok za odustanak u skladu sa stavom 1. ovog člana. Rok za odustanak za oba ugovora će se računati na osnovu odredaba stava 2. ovog člana pošto se primenjuju na ugovor o korišćenju nepokretnosti u svrhu odmora.</p> <p style="text-align: center;">Član 111 Modaliteti za ostvarivanje prava na odustanak od ugovora o ograničenom korišćenju nekretnina u svrhu odmora, dugoročnom korišćenju proizvoda za odmor, preprodaju i razmenu</p> <p>Kada potrošač namerava da iskoristi pravo na odustanak, potrošač mora, pre isteka roka za odustanak, obavestiti trgovca na papiru ili drugom trajnom mediju o odluci o odustanku. Potrošač može koristiti standard sa formom koji će biti utvrđen podzakonskim aktom iz stava 2. člana 105. ovog zakona dostavljen od trgovca u skladu sa stavom 1. člana 109. ovog zakona. Smatra se da je rok ispoštovan ako je</p>
---	---	---

<p>se afati i fundit kohor është përmbushur në qoftë se njoftimi është dërguar para se periudha e tërheqjes të ketë skaduar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 112</p> <p style="text-align: center;">Efektet e ushtrimit të së drejtës për tërheqje të kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit</p> <p>1. Ushtrimi i së drejtës së tërheqjes nga konsumatori heq detyrimin e palëve për të përmbushur kontratën.</p> <p>2. Kur konsumatori ushtron të drejtën për tërheqje, konsumatori nuk do të mbajë asnjë kosto dhe nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë vlerë korresponduese mbi shërbimet të cilat mund të jenë shfaqur para tërheqjes.</p>	<p>deadline is met if the notification is sent before the withdrawal period has expired.</p> <p style="text-align: center;">Article 112</p> <p style="text-align: center;">Effects of exercising the right of withdrawal from timeshare, long-term holiday product, resale and exchange contracts</p> <p>1. The exercise of the right of withdrawal by the consumer terminates the obligation of the parties to perform the contract.</p> <p>2. Where the consumer exercises the right of withdrawal, the consumer shall neither bear any cost nor be liable for any value corresponding to the service which may have been performed before withdrawal.</p>	<p>obaveštenje poslato pre isteka roka za odustanak.</p> <p style="text-align: center;">Član 112</p> <p style="text-align: center;">Efektii ostvarivanja prava na odustanak od ugovora o ograničenom korišćenju nekretnina u svrhu odmora, dugoročnom korišćenju proizvoda za odmor, preprodaju i razmenu</p> <p>1. Ostvarivanje prava na odustanak od strane potrošača uklanja obavezu strana da ispune ugovor.</p> <p>2. Kada potrošač koristi pravo odustanka, potrošač neće snositi nikakve troškove i neće biti odgovoran za bilo kakvu odgovarajuću vrednost usluga koje su se možda pojavile pre odustanka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 113</p> <p style="text-align: center;">Pagesat avans te kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit</p> <p>1. Në raport me kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit dhe shkëmbimit, çdo pagesë avans, dhënie garancie, rezervim i parave në llogari, njohje e borxhit apo ndonjë</p>	<p style="text-align: center;">Article 113</p> <p style="text-align: center;">Advance payment in timeshare, long-term holiday product, resale and exchange contracts</p> <p>1. In relation to timeshare, long-term holiday product and exchange contracts, any advance payment, provision of guarantees, reservation of money on accounts, explicit acknowledgement of debt or any other consideration to the trader or to</p>	<p style="text-align: center;">Član 113</p> <p style="text-align: center;">Avansna plaćanja na ugovore o ograničenom korišćenju nekretnina u svrhu odmora, dugoročnom korišćenju proizvoda za odmor, preprodaju i razmenu</p> <p>1. U vezi sa ugovorima o korišćenju nepokretnosti na određeno vreme u svrhu odmora, dugoročnog korišćenja proizvoda za odmor i razmene, bilo kakvog avansa, garancije, rezervacije novca na računu,</p>

<p>konsideratë tjetër ndaj tregtarit ose ndonjë pale të tretë nga konsumatori është e ndaluar para përfundimit të periudhës së tërheqjes sipas nenit 109 të këtij ligji.</p> <p>2. Në raport me kontratat e rishitjes, çdo pagesë avans, dhënie garancie, rezervim i parave në llogari, njohje e qartë e borxhit ose çdo konsideratë tjetër ndaj tregtarit ose të ndonjë pale të tretë nga konsumatori është e ndaluar para se të ndodh shitja aktuale ose përndryshe kur kontrata e rishitjes është ndërprerë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 114 Dispozitat e veçanta në lidhje me kontratat e shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit</p> <p>1. Sa i përket kontratave për produkte të pushimeve afatgjate, pagesat duhet të bëhen në pajtim me orarin e përcaktuar të pagesave. Çdo pagesë e çmimit të specifikuar në kontratë që nuk është në përputhje me orarin e përcaktuar të pagesave duhet të ndalohet. Pagesat, përfshi tarifat për anëtarësim duhet të ndahen në këste vjetore në vlera të barabarta. Tregtari duhet të dërgojë një kërkesë me shkrim për pagesë, në letër apo në ndonjë medium tjetër të qëndrueshëm, së paku katërbëdhjetë (14) ditë para çdo date të caktuar sipas orarit.</p>	<p>any third party by the consumer before the end of the withdrawal period, according to Article 109 of this Law, shall be prohibited.</p> <p>2. In relation to resale contracts, any advance payment, provision of guarantees, reservation of money on accounts, explicit acknowledgement of debt or any other consideration to the trader or to any third party by the consumer before the actual sale takes place or the resale contract is otherwise terminated, shall be prohibited.</p> <p style="text-align: center;">Article 114 Specific provisions relating to long-term holiday product contracts</p> <p>1. For long-term holiday product contracts, payment shall be made according to a staggered payment schedule. Any payment of the price specified in the contract otherwise than in accordance with the staggered payment schedule shall be prohibited. The payments, including any membership fee, shall be divided into yearly instalments, each of which shall be of equal value. The trader shall send a written request for payment, on paper or another durable medium at least fourteen calendar (14) days in advance of each due date.</p>	<p>priznanja duga ili bilo koja druga naknada trgovcu ili bilo kojoj trećoj strani od potrošača je zabranjeno pre isteka roka za odustanak prema članu 109. ovog zakona.</p> <p>2. U vezi sa ugovorima o preprodaji, zabranjeno je svako avansno plaćanje, davanje garancije, rezervisanje novca na računu, izričito priznanje duga ili bilo koja druga naknada trgovcu ili bilo kojoj trećoj strani od strane potrošača pre nego što se stvarna prodaja dogodi ili kada je raskinut ugovor o preprodaji.</p> <p style="text-align: center;">Član 114 Posebne odredbe u vezi sa ugovorima o dugoročnom korišćenju proizvoda za odmor</p> <p>1. Što se tiče ugovora za dugoročne proizvode za odmor, plaćanja se moraju izvršiti u skladu sa utvrđenim rasporedom plaćanja. Svako plaćanje cene navedene u ugovoru koje nije u skladu sa utvrđenim rasporedom plaćanja mora se obustaviti. Uplate, uključujući članarinu, moraju biti podeljene na godišnje rate jednake vrednosti. Trgovac mora poslati pismeni zahtev za plaćanje, na papiru ili na drugom trajnom mediju, najmanje četrnaest (14) dana pre svakog zakazanog datuma.</p>
--	--	---

<p>2. Nga pagesa e këstit të dytë e tutje, konsumatori mund të ndërpresë kontratën pa pësuar asnjë dënim duke njoftuar tregtarin brenda katërbëdhjetë (14) ditëve nga marrja e kërkesës për pagesën e secilit këst. Kjo e drejtë nuk do të ndikojë në të drejtat për ndërprerjen e kontratës sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit përkatës për të Drejtat Detyrimore.</p>	<p>2. From the second instalment payment onwards, the consumer may terminate the contract without incurring any penalty by giving notice to the trader within fourteen (14) calendar days of receiving the request for payment of each instalment. This right shall not affect the rights to terminate the contract under the general provisions of the Law on Obligational Relationships.</p>	<p>2. Od uplate druge rate pa nadalje, potrošač može raskinuti ugovor bez ikakve kazne tako što će obavestiti trgovca u roku od četrnaest (14) dana od prijema zahteva za plaćanje svake rate. Ovo pravo neće uticati na prava na raskid ugovora prema opštim odredbama relevantnog zakona o obligacionim pravima .</p>
<p style="text-align: center;">Neni 115 Ndërprerja e kontratave ndihmëse</p>	<p style="text-align: center;">Article 115 Termination of ancillary contracts</p>	<p style="text-align: center;">Član 115 Raskid pomoćnih ugovora</p>
<p>1. Kur konsumatori ushtron të drejtën për t'u tërhequr nga kontrata kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, çdo kontratë ndihmëse e këmbimit për atë ose ndonjë kontratë tjetër ndihmëse ndërpritet automatikisht, pa asnjë kosto për konsumatorin.</p>	<p>1. Where the consumer exercises the right to withdraw from the timeshare or long-term holiday product contract, any exchange contract ancillary to it or any other ancillary shall be is automatically terminated, at no cost to the consumer.</p>	<p>1. Kada potrošač ostvari pravo da odustane od ugovora o korišćenju nepokretnosti na određeno vreme u svrhu odmora, dugoročnog korišćenja proizvoda za odmor, svaki pomoćni ugovor o razmeni za taj ili bilo koji drugi pomoćni ugovor se automatski raskida, bez ikakvih troškova za potrošača.</p>
<p>2. Kur çmimi është i mbuluar plotësisht ose pjesërisht nga një kredi e dhënë për konsumatorin nga tregtari ose nga një palë e tretë në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet palës së tretë dhe tregtarit, pa paragjykuar nenin 97 të këtij ligji, marrëveshja e kredisë do të ndërpritet, pa kosto për konsumatorin kur konsumatori ushtron të drejtën të tërhiqet nga kontrata e pushimeve me afat, kontrata e produkteve për pushime afatgjata, kontratës për rishitje ose shkëmbimit.</p>	<p>2. Where the price is fully or partly covered by a credit granted to the consumer by the trader, or by a third party on the basis of an arrangement between the third party and the trader, without prejudice to Article 97 of this Law, the credit agreement shall be terminated, at no cost to the consumer, where the consumer exercises the right to withdraw from the timeshare, long-term holiday product, resale or exchange contract.</p>	<p>2. Kada je cena u potpunosti ili delimično pokrivena kreditom koji je potrošaču odobrio trgovac ili treće lice na osnovu ugovora između trećeg lica i trgovca, ne dovodeći u pitanje član 97. ovog zakona, ugovor o kreditu će biti raskinut, bez ikakvih troškova za potrošača kada potrošač iskoristi pravo da odustane od ugovora o odmoru na određeno vreme, ugovora o proizvodima za dugoročni odmor, ugovora o preprodaji ili razmeni.</p>

<p>KREU XIII TRAJTIMI I ANKESAVE TË KONSUMATORËVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 116 Ankesat e konsumatorëve</p> <p>1. Konsumatori ka të drejtë të parashtojë ankesë ndaj tregtarit nga i cili është blerë produkti, në rast të moskonformiteteve të produktit dhe të kontratës, në lidhje me çështjet e garantuara, për shkak të blerjes, si dhe arsyeve të tjera të ngjashme, në pajtim me Ligjin.</p> <p>2. Blerja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të krijohet mbi bazën e faturës për blerjen e produktit, kontratës së shitjes dhe kartën e garancisë ose në mënyrë tjetër përkatëse.</p> <p>3. Ankesa e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, do të dorëzohet me shkrim, ose në ndonjë mjet tjetër të qëndrueshëm, në dispozicion të konsumatorit.</p> <p>4. Tregtari duhet në objektin e shitjes dhe në vend të dukshëm të paraqesë informatat për mënyrën dhe vendin e parashtrimit të ankesës, dhe kur arrin marrëveshje duhet të njoftojë konsumatorin për këtë në një mënyrë të përshtatshme.</p>	<p>CHAPTER XIII HANDLING OF CONSUMER COMPLAINTS</p> <p style="text-align: center;">Article 116 Consumer complains</p> <p>1. The customer has the right to file a complaint against the trader from whom the product was purchased in case of nonconformity between the product and the contract, concerning issues guaranteed, due to the purchase, as well as other reasons related, in accordance with the Law.</p> <p>2. The purchase referred to in paragraph 1 of this Article may be established on the basis of the invoice for the purchase of the product, sales contract and warranty card or in another appropriate manner.</p> <p>3. The complaint referred to in paragraph 1. of this Article shall be submitted on paper or in any other durable medium, accessible to the consumer.</p> <p>4. The seller shall, in the premises of sale and in a visible place, submit information on the manner and place of filing the complaint, and when an agreement is reached, shall notify the customer about this in an appropriate manner.</p>	<p>GLAVA XIII REŠAVANJE ŽALBE POTROŠAČA</p> <p style="text-align: center;">Član 116 Žalbe potrošača</p> <p>1. Potrošač ima pravo da podnese žalbu trgovcu od koga je proizvod kupljen, u slučaju neusaglašenosti proizvoda i ugovora, u vezi sa garantovanim pitanjima, zbog kupovine, kao i iz drugih sličnih razloga, u skladu sa Zakonom.</p> <p>2. Kupovina iz stava 1. ovog člana može se utvrditi na osnovu računa za kupovinu proizvoda, kupoprodajnog ugovora i garantnog lista ili na drugi relevantan način.</p> <p>3. Žalba iz stava 1. ovog člana podnosi se u pisanoj formi, ili na bilo koji drugi trajni način koji je dostupan potrošaču.</p> <p>4. Trgovac mora u prodajnom objektu i na vidnom mestu da iznese podatke o načinu i mestu podnošenja žalbe, i kada postigne saglasnost mora o tome na odgovarajući način da obavesti potrošača.</p>
---	---	---

<p>5. Barra e provës së detyrimit të përmendur në paragrafin 4 të këtij neni do të jetë mbi tregtarin.</p> <p>6. Tregtari mban evidencë mbi ankesat e parapara në paragrafin 1 të këtij neni dhe të njëjtën duhet mbajtur të paktën dy vjet nga dita që ai/ajo ka marrë ankesën e konsumatorit.</p> <p>7. Evidenca e paraparë në paragrafin 6 të këtij neni, duhet të përmbajë informacion mbi ankesën dhe datën e marrjes së ankesës, produktin, fushën dhe çështjen e ankesës, si dhe datën e lëshimit të njoftimit të paraparë në nenin 117, paragrafin 4 të këtij ligji, dhe që ajo të jetë mbajtur në formën e librit të kopjes fizike apo në format elektronik.</p> <p>8. Tregtari është i detyruar të sigurojë praninë e një personi të autorizuar për të pranuar ankesat në vendin e dorëzimit të ankesave gjatë orarit të punës.</p>	<p>5. The burden of proof of the obligation referred to in paragraph 4. of this Article shall be upon the trader.</p> <p>6. The trader shall keep evidence on complaints referred to in paragraph 1 of this Article and he/she shall keep the same at least two years from the date he/she received the customer complaint.</p> <p>7. The evidence referred to in paragraph 6 of this Article shall contain information on the complaint and the date of receipt of the complaint, the product, the scope and case of the complaint and the date of issuance of the notice referred to in paragraph 4 of Article 117 of this Law, and it shall be kept in the form of a book of hard copy or in electronic format.</p> <p>8. The trader is obliged to ensure the presence of a person authorised to receive complaints in the place of submission of complaints during working hours.</p>	<p>5. Teret dokazivanja obaveze iz stava 4. ovog člana snosiće trgovac.</p> <p>6. Trgovac vodi evidenciju o žalbama iz stava 1. ovog člana i ista se mora čuvati najmanje dve godine od dana prijema žalbe potrošača.</p> <p>7. Evidencija iz stava 6. ovog člana mora da sadrže podatke o pritužbi i datumu prijema žalbe, proizvodu, oblasti i predmetu žalbe, kao i datum izdavanja obaveštenja iz člana 117. stav 4. ovog zakona i da je vođena u obliku knjige fizičkog primerka ili u elektronskom formatu.</p> <p>8. Trgovac je dužan da obezbedi prisustvo lica ovlašćenog za prijem pritužbi na mestu podnošenja žalbi u toku radnog vremena.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 117 Zgjidhja e ankesave</p> <p>1. Tregtari është i detyruar t'i përgjigjet konsumatorit pa vonesë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e pranimit të ankesës, në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër, në një medium të qëndrueshëm në dispozicion të konsumatorit, me vlerësimin për</p>	<p style="text-align: center;">Article 117 Resolution of complaints</p> <p>1. The trader shall be obliged to respond to the customer without delay, no later than fifteen (15) days from the receipt of the complaint, in writing or in any other form, in a durable medium accessible to the customer, with the evaluation on</p>	<p style="text-align: center;">Član 117 Rešavanje žalbi</p> <p>1. Trgovac je dužan da potrošaču bez odlaganja, najkasnije u roku od petnaest (15) dana od dana prijema pritužbe, odgovori u pisanoj formi ili na bilo koji drugi način, na trajnom mediju dostupnom potrošaču, sa</p>

<p>përmbajtjen e ankesës, që përmban propozimin për zgjidhjen e saj.</p> <p>2. Në qoftë se ankesa nuk zgjidhet menjëherë, tregtari është i detyruar të lëshojë një njoftim me shkrim mbi pranimin e ankesës së konsumatorit.</p> <p>3. Barra e provës në lidhje me detyrimin për të nxjerrë njoftimin e konsumatorit do të jetë mbi tregtarin.</p> <p>4. Njoftimi i paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të përmbajë të dhënat nga evidenca, e paraparë në nenin 116, paragrafi 7 të këtij ligji, si dhe datën e lëshimit të njoftimit.</p> <p>5. Rregullatorët apo trupat e tjerë kompetent për të vendosur ndaj ankesës së konsumatorit kundrejt vendimit të tregtarit, nëse nuk parashihet ndryshe përmes një rregulloreje të veçantë, marrin vendim ne periudhë kohore prej dy (2) muajsh nga data e ankesës.</p>	<p>the content of the complaint, containing a proposal for its resolution.</p> <p>2. If the complaint is not resolved immediately, the trader shall be obliged to issue a written notice on receipt of consumer complaints.</p> <p>3. The burden of proof regarding the obligation to issue a notice to the customer shall be upon the trader.</p> <p>4. The notice referred to in paragraph 2 of this Article shall contain the data from the evidence referred to in paragraph 7 of Article 116 of this Law, and the date of issue of the notice.</p> <p>5. Regulators or other competent bodies to decide regarding the consumer appeal against the decision of the trader, unless otherwise provided by special regulation, shall take a decision in the time period of two (2) months from the date of appeal.</p>	<p>ocenom o sadržaju pritužbe koja sadrži predlog za njeno rešavanje.</p> <p>2. Ukoliko pritužba nije odmah rešena, trgovac je dužan da izda pismeno obaveštenje o prihvatanju pritužbe potrošača.</p> <p>3. Teret dokazivanja u vezi sa obavezom izdavanja obaveštenja potrošaču je na trgovcu.</p> <p>4. Obaveštenje iz stava 2. ovog člana mora da sadrži podatke iz evidencije iz člana 116. stav 7. ovog zakona, kao i datum izdavanja obaveštenja.</p> <p>5. Regulatorni ili drugi organi nadležni da odlučuju o prigovoru potrošača na odluku trgovca, osim ako posebnim propisom nije drugačije određeno, odluku donose u roku od dva (2) meseca od dana prigovora .</p>
--	---	--

<p>KREU XIV MBROJTJA JURIDIKE DHE ADMINISTRATIVE E KONSUMATORËVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 118 Kërkesa për mbrojtjen e konsumatorit</p> <p>1. Nëse një tregtar nuk i përgjigjet ankesës së konsumatorit brenda afatit të paraparë në nenin 116 paragrafi 1 të këtij ligji, konsumatori mund të paraqesë një kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij sipas këtij ligji pranë organit administrativ kompetent për inspektim dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, i cili do të ndërmarrë masa në përputhje me këtë ligj.</p> <p>2. Në qoftë se një tregtar refuzon një ankesë, konsumatori mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij te një autoritet inspektues ose mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij sipas një procedure gjyqësore apo procedurave jashtë-gjyqësore.</p> <p>3. Në rastet e parapara në paragrafin 2 të këtij neni, në qoftë se një kërkesë për mbrojtjen e të drejtave është paraqitur te një autoritet kompetent inspektues i cili mundet, nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë dhe/ose me ndërmarrjen e veprimeve të tjera të caktuara, pa përfshirjen e ekspertëve dhe organizatave, të përcaktoj që të drejtat e konsumatorit në bazë të këtij ligji janë shkelur, veçanërisht të drejtat në lidhje me çmimet,</p>	<p>CHAPTER XIV ADMINISTRATIVE AND LEGAL PROTECTION OF CONSUMERS</p> <p style="text-align: center;">Article 118 Request for consumer protection</p> <p>1. If a trader does not respond to the customer's complaint within the period referred to in paragraph 1 of Article 117 of this Law, the consumer may file a request for protection of his rights under this Law at the administrative body responsible for inspection and supervision of the implementation of this the Law, which will take action in accordance with this Law.</p> <p>2. If a trader rejects a complaint, the customer may file a request for protection of his rights to an inspection authority or seek protection of his rights by a court proceeding or extrajudicial procedures.</p> <p>3. In cases referred to in paragraph 2 of this Article, if a request for protection of rights was submitted to a competent inspection authority which may, by direct observation and/or undertaking other certain actions, without the involvement of experts and organisations, determine that the consumer's rights according to this Law are violated, especially the rights regarding the prices, guarantee, conformity of</p>	<p>GLAVA XIV PRAVNA I ADMINISTRATIVNA ZAŠTITA POTROŠAČA</p> <p style="text-align: center;">Član 118 Zahtev za zaštitu potrošača</p> <p>1. Ako trgovac ne odgovori na pritužbu potrošača u roku iz člana 116. stav 1. ovog zakona, potrošač može podneti zahtev za zaštitu svojih prava iz ovog zakona nadležnom upravnom organu radi uvida i nadzora nad sprovođenjem ovog zakona, koji će preduzeti mere u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>2. Ako trgovac odbije pritužbu, potrošač može da podnese zahtev za zaštitu svojih prava inspeksijskom organu ili može zatražiti zaštitu svojih prava po sudskom ili vanparničnom postupku.</p> <p>3. U slučajevima iz stava 2. ovog člana, ako se zahtev za zaštitu prava podnosi nadležnom inspeksijskom organu koji može neposrednim posmatranjem i/ili preduzimanjem drugih određenih radnji, bez angažovanja stručnjaka i organizacija, da utvrdi da su povređena prava potrošača iz ovog zakona, a posebno prava koja se odnose na cene, garanciju, kompatibilnost proizvoda, oštećenje</p>
--	--	---

<p>garancinë, përputhshmërinë e produkteve, dëmtimin e produktit të dhënë për riparim, kushte të padrejta në kontrata dhe praktikat e padrejta tregtare, autoriteti kompetent i inspektimit do të ndërmarr masa dhe udhëzon tregtarin për të vepruar në lidhje me ankesën e konsumatorit në përputhje me këtë ligj.</p> <p>4. Nëse autoriteti kompetent i inspektimit nuk është në gjendje të vendosë, në bazë të veprimeve të zbatuara të parapara në paragrafin 3 të këtij neni, nëse të drejtat e një konsumatori në bazë të këtij ligji janë shkelur, do të informojë konsumatorin me shkrim se ai mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij në institucione jashtë-gjyqësore ose përmes procedurës gjyqësore.</p> <p>5. Asgjë në këtë nen nuk do të parandalojë konsumatorin për të kërkuar ndihmë në gjykatë ose jashtë procedurave gjyqësore edhe para se ai / ajo t'i drejtohet me ankesë tregtarit.</p>	<p>products, product damage given for repair, unfair terms in contracts and unfair trading practices, shall undertake actions and guide the trader to act regarding the complaint of the customer in accordance with this Law.</p> <p>4. If the competent inspection authority is not able to decide, on the basis of the implemented actions referred to in paragraph 3 of this Article, if the rights of a consumer under this Law are violated, shall inform the customer in writing that he may request protection of his/her rights in extrajudicial institutions or through judicial proceedings.</p> <p>5. Nothing in this Article shall prevent the customer from seeking assistance in court or out-of-court proceedings even before he/she addresses a complaint against the trader.</p>	<p>proizvoda datog na popravku, nepoštene uslove u ugovorima i praksu nelojalne trgovine, nadležni inspekcijski organ će preduzeti mere i uputiti trgovca da postupi po prigovoru potrošača u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>4. Ako nadležni inspekcijski organ nije u mogućnosti da na osnovu sprovedenih radnji iz stava 3. ovog člana utvrdi da li su povređena prava potrošača iz ovog zakona, obavestiće potrošača u pisanoj formi da može tražiti zaštitu njegovih prava u vansudskim institucijama ili putem sudskog postupka.</p> <p>5. Ništa u ovom članu ne sprečava potrošača da potraži pomoć u sudskom ili vansudskom postupku čak i pre nego što on/ ona se obraća pritužbom trgovcu.</p>
---	--	---

<p>KREU XV</p> <p>MBROJTJA GJYQËSORE E INTERESAVE TË KONSUMATORIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 119</p> <p style="text-align: center;">Urdhërveprimi për mbrojtjen e interesave kolektive të konsumatorëve</p> <p>1. Në qoftë se një tregtar përdor dispozita të padrejta kontraktuale, praktika biznesi, ose në çfarë do mënyre tjetër shkel të drejtat e konsumatorëve të parapara me këtë ose tjetër Ligj, dhe në këtë mënyrë shkel interesat kolektive të konsumatorëve, një padi mund të iniciohet kundër tij duke kërkuar ndërprerjen ose ndalimin e një shkelje të tillë (në tekstin e mëtejshëm: padi kolektive).</p> <p>2. Padia kolektive mund të iniciohet kundër një tregtari individual apo grupi tregtarësh nga i njëjti sektor ekonomik, kundër odave apo shoqatave ekonomike të tregtarëve të cilët inkurajojnë ose rekomandojnë praktika ose përdorimin e kushteve të kontratës, mbi të cilat kërkohet ndërprerje, ose kundër një hartuesi të një Kodi të sjelljes, kur ai kod promovon përdorimin e praktikave të paligjshme të biznesit, siç përcaktohet në dispozitat e nenit 73 të këtij ligji.</p>	<p>CHAPTER XV</p> <p>JUDICIAL PROTECTION OF THE CONSUMER INTERESTS</p> <p style="text-align: center;">Article 119</p> <p style="text-align: center;">Action-order on the protection of consumers' collective interests</p> <p>1. If a trader uses unfair contractual provisions, business practices, or in any other way violates consumer rights determined by this or other Laws, and thus violates the collective interests of consumers, then an action that requires the termination or prohibition of such violation may be initiated against him/her (hereinafter: the collective action).</p> <p>2. The collective action can be initiated against an individual trader or a group of traders from the same economic sector against the economic chambers or associations of traders who encourage or recommend the practice or the use of contract conditions, on which is required a termination, or against a drafter of a Code of Conduct, when that code promotes the use of illegal business practices, as defined in the provisions of Article 73 of this Law.</p>	<p>GLAVA XV</p> <p>SUDSKA ZAŠTITA INTERESA POTROŠAČA</p> <p style="text-align: center;">Član 119</p> <p style="text-align: center;">Upravni postupak zaštite kolektivnih interesa potrošača</p> <p>1. Ako trgovac koristi nepravične ugovorne odredbe, nepoštenu poslovnu praksu ili na bilo koji drugi način krši prava potrošača propisana ovim ili drugim zakonom i time povređuje kolektivne interese potrošača, protiv njega se može pokrenuti tužba kojom se traži prestanak ili zabranu takvih povreda (u daljem tekstu: kolektivna tužba).</p> <p>2. Kolektivna tužba se može pokrenuti protiv pojedinačnog trgovca ili grupe trgovaca iz istog privrednog sektora, protiv komora ili privrednih udruženja trgovaca koji podstiču ili preporučuju praksu ili korišćenje uslova ugovora, na osnovu kojih se traži raskid, ili protiv sastavljača nacрта Kodeksa ponašanja, kada taj kodeks promoviše upotrebu nedozvoljenih poslovnih praksi, definisanih odredbama člana 73. ovog zakona.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 120 Personat e autorizuar për të iniciuar procedurat</p> <p>1. Padia kolektiv mund të iniciohet nga:</p> <p>1.1. Inspektoratet dhe Rregullatorët brenda fushave të tyre specifike;</p> <p>1.2. Odat dhe asociacionet e interesave ekonomike nga fusha përkatëse e biznesit;</p> <p>1.3. Subjektet e kualifikuara si organizatat e certifikuar të konsumatorëve të cilat mbulojnë sektorin me të cilin ndërlidhet shkelja;</p> <p>1.4. Individit në emër të interesit kolektiv mund të ushtrojë padi sipas autorizimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 120 Persons authorised to initiate procedures</p> <p>1. Collective action may be initiated by:</p> <p>1.1. Inspectorates and Regulators within their specific areas;</p> <p>1.2. Chambers and associations of economic interests from the relevant area of business;</p> <p>1.3. Qualified entities such as certified consumer organisations which cover the sector to which the breach;</p> <p>1.4. The individual on behalf of collective interest may file a lawsuit as per the power of attorney.</p>	<p style="text-align: center;">Član 120 Lica ovlašćena za pokretanje postupka</p> <p>1. Kolektivnu akciju mogu pokrenuti:</p> <p>1.1. Inspektorati i regulatori u okviru svojih specifičnih oblasti;</p> <p>1.2. Komore i udruženja privrednih interesa iz relevantne oblasti poslovanja;</p> <p>1.3. Kvalifikovani subjekti kao što su sertifikovane potrošačke organizacije koje pokrivaju sektor sa kojim je kršenje povezano;</p> <p>1.4. Pojedinaac u ime kolektivnog interesa može podneti tužbu po ovlašćenju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 121 Veprimet që u paraprijnë procedurave gjyqësore</p> <p>1. Para inicimit të padisë kolektive, personi i autorizuar duhet të informoj me shkrim personin kundër kujt pretendohet padia, në rast se ata nuk e ndërpresin shkeljen, atëherë padia kolektiv do të iniciohet kundër tyre.</p>	<p style="text-align: center;">Article 121 Actions preceding court proceedings</p> <p>1. Before the initiation of collective action, the authorised person must inform in writing the person against whom the claim is claimed, and in case they do not terminate the violation, the collective action shall be initiated against them.</p>	<p style="text-align: center;">Član 121 Radnje koje prethode sudskom postupku</p> <p>1. Pre pokretanja kolektivne tužbe, ovlašćeno lice mora pismenim putem obavestiti lice protiv koga se tužba navodi, ako ne prestane sa povredom, protiv njega će biti pokrenuta kolektivna tužba.</p>

<p>2. Personi i autorizuar mund të inicioi padi kolektive vetëm pas katërbëdhjetë (14) ditëve nga data e dorëzimit të njoftimit sikurse parashihet në paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p>3. Kërkesa për lëshimin e masës së përkohshme mund të iniciohet te gjyqësori me propozim të personit të autorizuar para skadimit të afatit sipas paragrafit 2 të këtij neni.</p>	<p>2. The authorised person may initiate a collective action only after fourteen (14) days from the date of the delivery of the notice as it appears in paragraph 1 of this Article.</p> <p>3. The action on the issuance of the temporary measure may be initiated to the judiciary with the proposal of the authorised person before the expiry of the period referred to in paragraph 2 of this Article.</p>	<p>2. Ovlašćeno lice može pokrenuti kolektivnu tužbu tek nakon četrnaest (14) dana od dana dostavljanja obaveštenja iz stava 1. ovog člana.</p> <p>3. Zahtev za izricanje privremene mere može se podneti u sudstvu na predlog ovlašćenog lica pre isteka roka iz stava 2. ovog člana.</p>
<p>Neni 122 Rregullat e veçanta të procedurës</p>	<p>Article 122 Specific rules of procedure</p>	<p>Član 122 Posebna pravila postupka</p>
<p>1. Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës, ka juridiksionin ekskluziv për shqyrtimin e rasteve të ndërlidhura me paditë kolektive.</p> <p>2. Vlera e lëndës së kontestuar përcaktohet nga gjykata.</p> <p>3. Gjykata duhet të përcaktoj vlerën e lëndës së kontestuar deri në pesëmijë (5.000) Euro, pavarësisht rëndësisë aktuale ekonomike të mosmarrëveshjes.</p> <p>4. Nëse vjen deri te reduktimi i vlerës së lëndës kontestuese, kujdes i veçantë duhet ti kushtohet se sa është çështja komplekse dhe fusha e mosmarrëveshjes, numrit të personave ndaj të</p>	<p>1. The Department for Commercial Matters operating within the Basic Court in Prishtina shall have the trial exclusive jurisdiction over proceedings on collective action.</p> <p>2. The value of the disputed matters is determined by the court.</p> <p>3. The court must determine the value of the disputed matters up to EUR five thousand (5,000), regardless of the current economic importance of the disputed matters.</p> <p>4. If it comes to the reduction of the value of the disputed matters, particular attention should be paid to the complexity and scope of the disputed matters, to the number of persons against whom</p>	<p>1. Odeljenje za ekonomske poslove u okviru Osnovnog suda u Prištini ima isključivu nadležnost za ispitivanje predmeta u vezi sa kolektivnim tužbama.</p> <p>2. Vrednost sporne predmeta utvrđuje sud.</p> <p>3. Sud mora utvrditi vrednost spornog predmeta do pet hiljada (5.000) evra, bez obzira na stvarni ekonomski značaj spora.</p> <p>4. Ukoliko dolazi do smanjenja vrednosti parničnog predmeta, posebnu pažnju treba obratiti na to koliko je pitanje složeno i oblast spora, broj lica protiv kojih je pokrenut</p>

<p>cilëve është iniciuar procedura dhe rëndësisë së kërkesës nga aspekti i interesit publik.</p> <p style="text-align: center;">Neni 123 Pezullimet dhe veprimet e ngjashme</p> <p>1. Në rastet kur procedurat për paditë kolektive janë në pritje, nuk mund të vendosen procedurat e tjera për mbrojtjen kolektive të konsumatorëve krahas të njëjtës padi ndaj të njëjtit të paditur.</p> <p>2. Personat e tjerë të autorizuar mund t'i bashkëngjiten padisë përgjatë procedurës, si ndërhyrës pa të drejtë rimbursimi.</p> <p>3. Procedurat e iniciuara lidhur me padinë kolektive nuk duhet të parandalojnë konsumatorin që vuan pasojat nga dëmtimet e shkaktuara nga shkelja e tregtarit, të inicioj procedurat për dëmet ose çfarë do procedurash tjera për ushtrimin e të drejtave që i përket atij bazuar mbi këtë ligj apo ligje të tjera pranë gjykatës kompetente.</p>	<p>the procedure is initiated and to the importance of the application in terms of public interest.</p> <p style="text-align: center;">Article 123 Suspensions and similar actions</p> <p>1. In cases where the collective action procedures are pending, other procedures on collective consumer protection in respect of the same claim against the same defendant cannot be imposed.</p> <p>2. Other authorised persons may join the claim during the procedure, as intruders without the right to reimbursement.</p> <p>3. The initiated collective action procedures should not prevent the consumer who suffers consequences from damages caused by trader violations, to initiate in the competent court the procedures for damages or any other procedures for the exercise of the rights that belong to him/her based on this Law or other laws.</p>	<p>postupak i značaj zahteva od tačke gledišta od javnog interesa.</p> <p style="text-align: center;">Član 123 Suspenzije i slične radnje</p> <p>1. U slučajevima u kojima je u toku postupak kolektivne tužbe, protiv istog okrivljenog se ne može pokrenuti drugi kolektivni postupak za zaštitu potrošača.</p> <p>2. U toku postupka tužbi se mogu priključiti i druga ovlašćena lica, kao zastupnici bez prava na naknadu .</p> <p>3. Postupci pokrenuti u vezi sa kolektivnom tužbom ne treba da sprečavaju potrošača koji trpi posledice štete prouzrokovane povredom trgovca, da pokrene postupak za naknadu štete ili druge postupke za ostvarivanje prava koja mu pripadaju na osnovu ovog zakona ili drugim zakonima pred nadležnim sudom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 124 Vendimi i gjykatës</p> <p>1. Nëse padia kolektive është e bazuar, parashihet që gjykata, në aktgjykimin e saj, të ia përcaktoj sa më detalisht të paditurit shkeljen e këtij apo ndonjë ligji tjetër në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 119 të këtij ligji:</p>	<p style="text-align: center;">Article 124 Court decision</p> <p>1. If the collective action is well founded, it is provided that the court, in its decision determines to the defendant in a detailed way the violation of this or any other law in accordance with paragraphs 1 and 2 of Article 119 of this Law:</p>	<p style="text-align: center;">Član 124 Sudske odluke</p> <p>1. Ukoliko je kolektivna tužba osnovana, predviđeno je da sud u svojoj presudi što detaljnije utvrdi okrivljenom povredu ovog ili nekog drugog zakona u skladu sa stavom 1. i 2. člana 119. ovog zakona. :</p>

